



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.11.2021 ora 13:00

Drejton mbledhjen:

Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit “Për bashkëqeverisjen” (*Komision përgjegjës*).

Marrin pjesë:

Klotilda Bushka, Klevis Xhoxhi, Saimir Hasalla, Xhemal Qefalia, Denis Deliu, Eduard Ndreca, Alqi Bllako, Oerd Bylykbashi, Gazmend Bardhi, Enkelejd Alibeaj, Saimir Korreshi, Greta Bardeli, Dashnor Sula, Fatmir Mediu, Damian Gjiknuri, Aurora Mara, Elda Hoti, Erisa Xhixho, Gerta Duraku, Toni Gogu, Gledis Çeliku, Bledion Nallbati, Jurgis Çyrbja, Ermonela Valikaj (Felaj), Dhurata Tyli, Arben Pëllumbi dhe Lavdrim Krrashi

Mungon:

Fatmir Xhafaj.

Të ftuar:

Elisa Spiropali – Ministre Shteti për Marrëdhëniet me Parlamentin

Eridana Çano – Drejtoreshë e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje

Vangelt Duni – Jurist i Njësisë së Akteve Rregullatore të Departamentit Rregullator dhe të Përputhshmërisë në Këshillin e Ministrave

HAPET MBLEDHJA

Klotilda Bushka – Përsëndetje, të nderuar kolegë të Komisionit të Ligjeve!

Fillojmë mbledhjen e komisionit të datës 2 nëntor 2021 me rend dite një çështje: shqyrtimi nën për nën dhe në tërësi i projektligjit “Për bashkëqeverisjen”, për të cilin ne jemi komision përgjegjës dhe unë do të jem edhe në cilësinë e relatores.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Kryeministria: zonja Elisa Spiropali, ministre e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, mirë se erdhët, zonja Ministre; zonja Eridana Çano, drejtoreshë e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, mirë se erdhët, si dhe zoti Vangelt Duni, jurist në Njësinë e Akteve Rregullatore të Këshillit të Ministrave.

Atëherë, kolegë, para se të fillojmë me shqyrtimin e çështjes në rend dite, më duhet t’ju them se në cilësinë e relatores së këtij projektligji kam kërkuar që ligji të hidhet për konsultim publik, sipas procedurave të Kuvendit, dhe kanë ardhur disa komente nga organizatat e shoqërisë civile, nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe CCL-ja, si dhe disa sugjerime për sa u takon neneve të caktuara të këtij projektligji. Do të doja t’i falënderoja për komentet dhe sugjerimet e vlefshme, të cilat janë marrë në konsideratë dhe u është dhënë një përgjigje çdo çështjeje të ngritur. Gjithashtu, anëtarë të komisionit kanë dërguar, pasi projektligji është miratuar në parim, komente të ndryshme nisur edhe nga diskutimet që ne kemi kryer në seancën e diskutimit në parim për të adresuar çështje, të cilat ose kanë nevojë për sqarim, ose kanë nevojë për amendamente sipas gjykimit tonë.

Në kuadër të këtij procesi, në cilësinë e relatores, kam punuar në grup teknik me përfaqësues nga Këshilli i Ministrave. Kam pasur në këtë grup, gjithashtu, këshilltarë të komisionit tonë, por na janë bashkuar në tryezën e diskutimeve teknike edhe këshilltarët e Komisionit të Ekonomisë (i cili e ka miratuar tashmë projektligjin edhe në parim, edhe nën për nën, edhe në tërësi), për të pasur një qasje të përbashkët në lidhje me përmbajtjen e neneve të caktuara të ligjit dhe kemi marrë në konsideratë çdo koment të ardhur.

Në përfundim të punës së grupeve teknike, në një nga mbledhjet e të cilëve ka marrë pjesë edhe një përfaqësues nga delegacioni i Bashkimit Europian në Shqipëri, kemi hedhur në tabelë, e cila tashmë ju është shpërndarë të gjithëve, në formën e paraqitur, siç e keni përpara: Në kolonën 1 është dispozita aktuale e projektligjit siç është depozituar nga Këshilli i Ministrave, në kolonën 2 janë komentet e ardhura me sqarimet përkatëse, çfarë merret parasysht dhe çfarë çmohet të mos ndryshojë, dhe në kolonën 3 është varianti i riformuluar me propozimet e mia, por, në fakt, nuk janë vetëm ato që unë kam çmuar të nevojshme, po edhe

ato që grupi i punës ra në dakordësi të plotë edhe me ne, edhe me përfaqësuesit e nismës, me përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave.

Në thelb, riformulimet që unë kam bërë dhe që i kam paraqitur në tabelë së bashku me një version integral të ligjit, kanë karakter teknik, nuk prekin thelbin e ligjit, por janë për të qartësuar më shumë normën ose, për efekt të teknikës legislative, në mënyrë që ligji të mos ketë probleme në zbatim, në praktikë.

Kështu që pa humbur kohë, duke qenë se të gjitha këto materiale që përmenda jua kam përmbledhur, do t'ju ftoja të fillonim me shqyrtimin nen për nen.

Oerd Bylykbashi – Për procedurë.

Klotilda Bushka – Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Zonja kryetare, ju thatë që e keni hedhur për konsultim publik dhe keni marrë një numër komentesh, si dhe që janë reflektuar.

Klotilda Bushka – Po.

(Ndërhyrje)

Oerd Bylykbashi – A nuk do të ishte, në fakt, më...

Klotilda Bushka – Është në tabelë, e keni këtu, nuk e keni parë.

Oerd Bylykbashi – Te cila?

Klotilda Bushka – Atëherë, edhe një herë, zoti Bylykbashi, për t'jua sqaruar, përveç versionit integral, keni edhe tabelën...

(Ndërhyrje)

Oerd Bylykbashi – Është kjo këtu?

Klotilda Bushka – Po. Në kolonën 2 të tabelës janë sugjerimet e ardhura dhe sqarimet qoftë nga konsultimi publik, qoftë komentet që kanë pasur kolegët e komisionit.

Dakord?

Oerd Bylykbashi – Dakord.

Klotilda Bushka – Fillojmë me shqyrtimin nen për nen të projektligjit.

Neni 1. Në nenin 1 kemi një riformulim për teknikë legislative, bëhet fjalë për objektin e projektligjit që, siç ju thashë, është ndërhyrje e karakterit teknik. Pra, për të evituar përsëritjet dhe për ta bërë më të qartë normën, neni 1 ndahet në dy paragrafë. Jeni dakord me nenin 1? Ka ndonjë riformulim?

(Ndërhyrje)

Në rregull. Mund të votojmë, sepse jemi në shqyrtim nen për nen dhe më duhet të shoh...

(Ndërhyrje)

Atëherë, pro? 12 vota pro. Kundër?

Oerd Bylykbashi – Ne kemi qenë kundër...

(Ndërhyrje)

Klotilda Bushka – Një sekondë, zoti Bylykbashi. Atëherë, rezultati i votimit për nenin 1 është: 12 vota pro, 3 vota kundër...

(Ndërhyrje)

4 kundër? Jini të vëmendshëm që t'i numëroj votat në mënyrë të saktë.

Atëherë, me 12 vota pro, 4 vota kundër dhe asnjë abstenim miratohet neni 1, me riformulimet sipas relatores.

Zoti Bylykbashi, çfarë kishit për të shtuar?

(Ndërhyrje)

Po, zoti Alibeaj, shpjegim vote.

Enkelejd Alibeaj – Shumë faleminderit, zonja kryetare!

Defektet e mëdha kushtetuese, madje edhe logjike, duken që në nenin 1 “Objekti”, ku keni futur së paku katër togfjalësha pa asnjë lloj kuptimi ligjor, pa asnjë lloj reference, madje në konfuzion me terminologjinë juridike të përdorur nëpër ligje të tjera tashmë të certifikuara.

Së pari, thoni: “Ky ligj përcakton rregullat për bashkëqeverisjen me qytetarët”. Pyetja që kam unë për këdo është: çfarë do të thotë “bashkëqeverisje”? Termi “qeverisje” është term kushtetues, përdoret në ligjin nr. 9000, kështu që është e domosdoshme të kërkohet, të jepet një shpjegim për të kuptuar çfarë lloj marrëdhënieje krijohet, çfarë të drejtash dhe detyrimesh, ndërmjet kujt dhe kujt, për të kuptuar realisht objektin, siç edhe emërtohet kjo dispozitë.

Së dyti, thoni: “Gjithëpërfshirjes së tyre në politikëbërje”. Me pak sforco dhe me dashamirësi, i bie që të kuptohet çfarë? Që politikat shtetërore nuk i përcaktuaka më, këtej e tutje, qeveria, Kryeministri, ministrat, siç i ka për detyrim kushtetues? Gjithëpërfshirje me kë, me cilat subjekte?

Së treti, thoni: “Pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse”. Si? Po ka një ligj (dhe këtu fillojnë edhe problemet kushtetuese) i cili përcakton aksesin në procedurat administrative, madje është ligj edhe me shumicë të cilësuar, Kodi i Procedurës Administrative, që përcakton se cilat janë subjektet (institucionet shtetërore dhe jo vetëm), që duhet të vozisin procedurën administrative, përcakton edhe të drejtën e qytetarëve, të të interesuarve, që kanë të drejtë të njihen, të marrin informacion me dokumentacion e me radhë. Çfarë do të thotë? Ju po vendosni që në nenin 1 të këtij ligji të kapërceni Kodin e Procedurës Administrative, i miratuar me shumicë të cilësuar? Dhe besoj që ju e kuptoni se kjo është një përplasje e madhe e natyrës kushtetuese.

Së katërti, thoni: “Rritjen e përgjegjshmërisë dhe të llogaridhënies së administratës shtetërore”. Me dashamirësinë më të madhe, dua të kuptoj që këtu bëhet fjalë për instrumente kontrolli, pra kontroll mbi administratën. Por kontrolli mbi administratën, përcaktuar në Kushtetutë, është gjithmonë ose administrativ (brenda për brenda administratës, në mënyrë hierarkike), që është njëra anë, ose gjyqësor. Nuk ka se si të ketë një rrugë të tretë. Dhe çfarë do të thotë kjo? Ky është dallimi i madh ndërmjet shtetit të së drejtës dhe shtetit rrumpallë. Ky është dallimi i madh. Pra, vetëm në nenin 1 ka së paku, po i quaj nocione, që kanë jo vetëm konfuzion në semantikë, por edhe në brendinë e tyre nuk bëjnë gjë tjetër veçse kapërcejnë ligje me shumicë të cilësuar, madje deri te Kushtetuta.

Vota ime ishte kundër, por, sigurisht, që do të duhet, nëse ka një synim të mbarë, të qartësohet. Kështu siç është, në katër pika keni përplasje me Kushtetutën.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Erdhët vonë, në fakt, ne e kemi miratuar nenin 1 dhe...

Oerd Bylykbashi – Sapo e shpjegoi votën.

Klotilda Bushka – Një sekondë, se nuk po them...

Oerd Bylykbashi – Të mos bëjmë komente tani...

(Ndërhyrje)

Xhemal Qefalia – Në qoftë se e ke për provokim, për procedurë...

Klotilda Bushka – Neni 1 i miratuar, me formulimin sipas amendamenteve të propozuara (kini durim, siç kam durim unë kur ju dëgjoj), është i ndarë tashmë në dy paragrafë, të cilët e kanë qartësuar objektin e ligjit në përcaktimin e rregullave për bashkëqeverisjen me qytetarët dhe të gjitha konceptet e tjera, si dhe në përcaktimin e mënyrës së organizimit, funksionimit dhe kompetencat e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

Meqenëse bëtë sqarim të votës kundër, po ju them se, për sa i takon termit “bashkëqeverisje”, duhet të kemi në konsideratë, në radhë të parë, që në bazë të këtij projektligji (se këto janë diskutime që i takojnë parimit)...

(Ndërhyrje)

Logjika është që kemi një mjet në dorë të qytetarëve, i cili është inovativ, dhe e kemi shpjeguar në seancën e shqyrtimit në parim të nismës që vjen në kuadër të deregulimit dhe të dixhitalizimit të shërbimeve, një mjet që është duke...

(Ndërhyrje)

Enkelejd Alibeaj – Ky shpjegimi që bëni ju, zonja kryetare...

Klotilda Bushka – Më falni pak!

Jo, thjesht po e sqaroj për efekt të...

Enkelejd Alibeaj – Unë kam të drejtën dhe çdokush ka të drejtën të shpjegojë votën kundër.

Klotilda Bushka – Sigurisht.

(Ndërhyrje)

A mund të mbaroj, se nuk po bëj replikë, por po e sqaroj për kolegët e komisionit?

Të lutem tani.

Pra, e gjithë logjika është që neni 1 përcakton qëllimin sipas asaj që miratuam në riformulim dhe në vijim i gjithë qëllimi...

(Deputeti Bylykbashi flet pa mikrofon.)

Neni 1, i cili sapo u miratua me riformulim, jep objektin e ligjit dhe në vijim projektligji ka të shtjelluar qartë të gjitha konceptet të cilat parashikohen atje.

Vazhdojmë me nenin 2 të projektligjit.

(Ndërhyrje)

Jo, vazhdojmë me nenin 2 dhe pastaj.

(Ndërhyrje)

Atëherë, në nenin 2 të projektligjit, varianti i depozituar nga nismëtarët, ka dy paragrafë. Për efekt të shmangies së përsëritjeve dhe për ta bërë më të saktë dhe më të qartë, në kuadër edhe të teknikës legjislative, në kolonën 3 të tabelës unë kam propozuar të riformulohet me përmbajtjen siç parashikohet atje, dhe do të jetë vetëm një paragraf.

Jeni dakord me nenin 2?

(Ndërhyrje)

Keni diskutim? Urdhëroni.

Enkelejd Alibeaj – Na jepni fjalën për diskutim, pastaj vota është e fundit.

Klotilda Bushka – Patjetër, nëse keni diskutime dhe riformulime, në rregull, mund ta merrni fjalën.

(Ndërhyrje)

Nëse doni vetëm të kundërshtoni, keni të drejtë që, kur të votoni kundër, të shpjegoni votën pas çdo neni.

(Ndërhyrje)

Enkelejd Alibeaj – Kam dëshirë të kundërshtoj, me thënë të drejtën. E kam të drejtën tani për ta dhënë shpjegimin.

(Ndërhyrje)

Klotilda Bushka – Në qoftë se ju, zoti Alibeaj, do të bëni komente për riformulime, mund ta merrni fjalën dhe të kundërshtoni. Nëse jeni kundër, merrni kohën dhe shpjegoni votën kundër.

Nëse doni të flisni tani, urdhëroni dhe flisni.

(Ndërhyrje)

Enkelejd Alibeaj – Sigurisht, për çdo nen.

Tani, për ta bërë të qartë, ne kemi ardhur të përgatitur. Për çdo nen do të kemi komentet tona. Madje, po jua them që tani, jemi kundër.

(Ndërhyrje)

Klotilda Bushka – E the dje, do të votojmë kundër në parim.

Enkelejd Alibeaj – Po pra, ti e bën dallimin midis parimit dhe nen për nen, dakord, dhe është e pritshme nga ana juaj që edhe nen për nen të dalim kundër.

(Ndërhyrje)

Kështu që për çdo dispozitë do të rezervoni të drejtën tonë për të folur.

Neni 2, pika 1, nuk ndryshon në asgjë nga neni 1, përveç një togfjalëshi: “Qëllimi i këtij ligji është të krijojë kushtet”. E gjithë pjesa tjetër: “Për bashkëqeverisjen me qytetarët, nëpërmjet gjithëpërfshirjes së tyre në politikëbërje, në garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse dhe rritjen e përgjegjshmërisë” e bla-bla-bla, është e njëjta si neni 1, tek objekti. Domethënë, kushdo, qoftë studenti i vitit të parë, drejtësi, që bën orën e parë të lëndës “E drejtë administrative” e kupton që në dy nene, te neni 1 “Objekti” dhe neni 2 “Qëllimi” kanë të njëjtën përmbajtje. Do të thotë se duket që kjo është bërë me shpejtësinë më të madhe. Nuk është ligj, nuk është projektligj, është poezi romantike e Ramës. Kaq e thjeshtë është kjo punë.

Kështu që, nuk ka se si të mund të jetë ndryshe vota e gjithkujt, jo vetëm jona, veçse kundër. Kjo ishte për paragrafin e parë.

Për paragrafin e dytë: “Ky ligj ka për qëllim të nxisë ndërveprimin”, kjo është fjalia kyçe “ndërveprimin”, kurse pjesa tjetër është pa vlerë.

Pyetja që kam unë dhe që duhet ta ketë kushdo është: çfarë koncepti është “ndërveprimi”? Marrëdhëniet individ-shtet dhe individ-pushtet publik krijohen duke saktësuar të drejtat dhe detyrat reciproke. Çfarë domethënë “ndërveprim”? Ç’është ky ndërveprim? A ka nevojë, minimumi, të qartësohet çfarë të drejtash shtesë po i ngarkoni shtetit? Çfarë detyrimesh po i ngarkoni individit dhe anasjelltas? Siguria juridike, që është koncepti bazë në ligjëbërje, kërkon pikërisht qartësimin e këtyre nocioneve. Instrumentet dihen tashmë.

Së dyti, po në të njëjtën pikë, fjalë kyçe keni: “Pra, ky ligj ka për qëllim të nxisë ndërmarrjen e nismave të projekteve ose programeve të përbashkëta”. Më falni, midis kujt? Çfarë do të thotë “e përbashkët”?

Në një shtet të së drejtës, neni 4 i Kushtetutës, ku e drejta është baza e veprimtarisë së shtetit, çështjet ndahen: shteti ka detyrime një, dy, tre, katër; publiku, qytetari, individi ka të drejta një, dy, tre, katër apo mundësi. Mbi cilësinë e këtij raporti, masës së detyrimeve të shtetit dhe të drejtave të individit përcaktohet dhe nxjerr konkluzionin: ke një shtet demokratik, ke një shtet autoritar e me radhë. Ju përdorni terma “ndërmarrja e nismave të projekteve ose të programeve të përbashkëta”... Çfarë domethënë “të përbashkëta”? Midis kujt? Pra, nocione të turbullta, nocione propagandistike, asgjë në substancë, dhe mendoni që kjo është e vendosur në nenin 2, te qëllimi i ligjit, që duhet të jetë nga dispozitat më të qarta për t’u kuptuar nga kushdo tjetër, sepse shërbejnë si instrumente për të lexuar përmbajtjen e dispozitave më vonë.

E pra, ja kjo është arsyeja pse është ligj i shkruar keq, me koncepte totalisht të vagëta, që është edhe ky një defekt i natyrës kushtetuese. E dini fare mirë që paqartësia në termat ligjorë në vetvete të çon në antikushtetutshmëri. E pra, ja kjo është arsyeja pse ne jemi kundër.

Është i lutur kushdo nga qeveria apo kushdo tjetër, ta qartësojë minimalisht.

(Ndërrhyrje)

Klotilda Bushka – Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Në vijim të së njëjtës, a përsëritje të çfarë tha zoti Alibeaj, fakti që të dy nenet qartazi kanë këtë turbullirë, më tepër jo thjesht për defekt të mënyrës se si e keni konceptuar, po është edhe qëllimi, pra bashkëqeverisje dhe ndërveprim, të gjitha këto janë për të krijuar konfuzion në përgjegjësinë e pastër që duhet të ketë shteti në dhënien e shërbimeve publike.

Qytetari ka të drejtat për t’i realizuar. Ia kërkon këto administratës publike. Për këto ekzistojnë procedura të përcaktuara qartë me ligje të tjera, përfshirë ligje me shumicë të cilësuar, siç e thamë edhe më përpara.

Tani ju, për të shmangur përgjegjësinë që keni, pra shteti duhet të ketë në lidhje me këtë, krijoni këto koncepte konfuze: “bashkëqeverisje”. Jo, zgjedhësit kanë votuar që të qeverisen nga ata që kanë marrë tagrin. Dhe, kur japin llogari në intervale të përcaktuara nga Kushtetuta, japin llogari për mënyrën se si kanë qeverisur, jo si kanë bashkëqeverisur. Pra, nuk bëhet palë në zullumin që bëni ju ai që ka nevojë për të marrë shërbime. Ku? Për pronën, për shëndetësinë, për arsimin e me radhë.

Se jua them edhe një herë, ju edhe titujt e neneve i keni vënë si tituj telenovelash. Nuk ka kuptim, se i bie që këtë ligj...

(Ndërhyrje)

Ta mbaroj.

I bie që këtë ligj ne duhet ta ndryshojmë edhe për faktin që, kur të ndryshojë titulli i platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”, ë, formulim poetik, në fakt, është për Shqipërinë që kemi, kjo që kemi, që ju po thoni se ne na duhet i gjithë ky ligji, sepse situata është e këtillë që të vëmë nën hyqëm këta të administratës sonë, që i kemi ne, por që nuk i kemi në kontroll, dhe të marrim tani si palë edhe publikun që t’i vëmë në vijë këta. Janë fjalë që hyjnë dhe dalin pa kuptim në këtë histori.

Dikush vjen, kërkon një të drejtë, administrata brenda afatesh të caktuara ka për detyrë t’i japë shërbimin. Nëse nuk i jep shërbimin, duhet të marrë përgjegjësinë. Dhe më pas politikisht, që është qeverisja, duhet të japë llogari me votë, kur i vjen radhe. Por jo që të thoni ju: e bëmë bashkë keq. Se morëm 180 mijë aplikime në portal dhe jepni edhe grafika me përqindje.

Janë të përcaktuara sot se çfarë detyrimesh ka.

Fakti që ju nuk jepni përgjigje ende për pronat, për shembull, për pronarët, si e zgjidhni me këtë bashkëqeverisjen ju?!

(Ndërhyrje)

Është temë që mua më intereson. Si? Jo mua si, por si politikanë, na intereson si e trajtoni çështjen e pronave. Dihet që keni 8 vjet që nuk bëni asgjë. Me këtë do ta zgjidhni ju, me këtë të bashkëqeverisjes?!

Po të gjitha shërbimet e tjera që kërkojnë shtetasit dhe nuk i marrin? Po në lidhje me shëndetësinë keni, se për arsimin keni? Të gjithë e dinë cila është situata dhe ju mendoni se me këto formulime të përgjithshme do të zgjidhni problemin.

Pra, ta bëjmë të qartë këtë histori, që në fillim është një ligj që ka efekt vetëm propagandën, do të krijojë konfuzion dhe do t’u krijojë më shumë problem shtetasve.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Bylykbashi!

Ju lutem, fokusohuni te neni...

Oerd Bylykbashi – Ai nen.

Klotilda Bushka – ... i riformuluar, që unë ju kam propozuar.

Oerd Bylykbashi – Për procedurë.

Klotilda Bushka – Për procedurë, duhet të keni të qartë që ju sot do të flisni nen për nen. Nuk mund t’i mblidhni të gjitha kritikrat dhe komentet që keni për ligjin në tërësi te neni përkatës...

(Ndërhyrje)

...sepse unë jam vetëm kryetare në këtë rast, por jam edhe relatore dhe, sigurisht, sa herë që do të shtrembërohet qëllimi i asaj që unë ju kam paraqitur, atë herë do ta marr fjalën për të folur. Ju lutem, procedura e shqyrtimit nen për nen kërkon të fokusoheni te neni përkatës, jo tek të gjitha çështjet që keni me ligjin.

Zoti Alibeaj, ishe në rregull, sepse fole për nenin përkatës, kurse zoti Bylykbashi, ju lutem fokusohuni te neni përkatës!

Fjalën për procedurë e ka kërkuar zonja Felaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Toni Gogu – Zonja kryetare, e kam kërkuar fjalën për procedurë më përpara.

Oerd Bylykbashi – Komente për fjalën tonë nuk bëni dot as ju dhe as kolegë të tjerë. Ne themi atë që mendojmë. Po flasim për qëllimin dhe gjë më të përgjithshme sesa ky qëllimi konfuz që keni ju këtu nuk ka.

Klotilda Bushka - Zoti Gogu, keni fjalën për procedurë.

Toni Gogu – Zonja kryetare, mbledhja nuk mund të vazhdojë në këtë mënyrë. Diskutimi në parim u bë mbledhjen e kaluar, kurse tani kemi hyrë në votim dhe, siç e thotë edhe Rregullorja e Kuvendit, do të votohet nen për nen. Sqarohet dhe ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka debat gjatë votimit nen për nen, sepse nuk e parashikon Rregullorja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka - Zoti Bylykbashi, mund ta lejoni zotin Gogu të mbarojë fjalën?

Toni Gogu – E para, ky bullizëm parlamentar ...

Oerd Bylykbashi – Tërhiqem.

Toni Gogu – Shumë faleminderit!

Zonja kryetare, kam kërkuar fjalën për procedurë dhe nuk po arrij ta mbaroj. Kur fjala merret për procedurë, do të thotë të kontribuosh në rendin e ditës, që mbledhja të funksionojë ashtu siç duhet. Kemi filluar votimin nen për nen, kurse diskutimi në parim është mbyllur në mbledhjen e kaluar, ku u thanë të gjitha këto argumente. Duhet të ndajmë një gjë. Votohet neni dhe nëse kanë amendamente, le t'i paraqesin që ne t'i shqyrtojmë ose nëse nuk kanë amendamente, një përfaqësues i tyre të shpjegojë votën kundër.

Oerd Bylykbashi – Jo, secili mund të ketë shpjegimin e vet.

Toni Gogu – Ndryshe, mbledhja po del jashtë shinave. Unë po ju kërkoj të merrni masa.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Gogu!

Fjalën e ka zonja Ermonela për procedurë.

Ermonela Felaj – Ndërhyrja ime për procedurë është e thjeshtë. Rregullorja parashikon kohën e sqarimit të votës kundër, kështu që në çdo rast ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, nëse kërkon të sqarosh votën kundër, ki parasysh që Rregullorja përcakton kohën 2 minuta për këtë gjë. Nga ana tjetër, në çdo rast do të shprehet një folës andej, një folës këtej, sepse nuk mund ta merrni ju të gjithë kohën në dispozicion për çdo nen. Dakord? Kështu që, procedojmë sipas këtyre rregullave dhe ne do t'ju dëgjojmë. Rendi i ditës së sotme është diskutimi dhe miratimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit.

Oerd Bylykbashi – Edhe një herë, çfarë është?

Ermonela Felaj - Diskutimi dhe miratimi nen për nen dhe në tërësi i projektligjit. I nenit, jo i ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, të lutem, të mos e kemi këtë komunikim! Unë ju dëgjova dhe nuk ju ndërhyra, ndaj më dëgjo edhe ti mua. Edhe unë mund të mos jem dakord për shumë gjëra që thoni ju, por e detyrova veten t'ju dëgjoj deri në fund. Pra, të vendosim një rregull, jo që e bëjmë ne këtu, por që e njih procedura, që, sipas rasti, për arsyen për të cilën e marrim fjalën, të bëjmë edhe diskutimin. Kjo ishte ndërhyrja ime.

Oerd Bylykbashi – Të lutem, për procedurë.

Klotilda Bushka – Jo, nuk ka procedurë. Do të hedh në votim nenin 2, me riformulimin e paraqitur nga unë si relatore.

12 vota pro. Kundër? Sekretaria të numërojë votat kundër.

Miratohet neni 2.

Vazhdojmë me nenin 3.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E sqaruat paraprakisht votën kundër, zoti Alibeaj.

Vazhdojmë me nenin 3. Fusha e zbatimit të ligjit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka diskutime? Jeni dakord me riformulimin?

Neni 3 miratohet me 12 vota. Kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, sekretaria numëroni votat kundër.

Zoti Alibeaj, keni të drejtë të shpjegoni votën kundër për nenin 3, të riformuluar sipas sugjerimit të relatorit.

Enkelejd Alibeaj – Zonjë, në qoftë se keni ngut për ta kaluar shpejt e shpejt, mund të votosh numra këtu, neni 1, neni 2, neni 3, por kjo nuk është as në respekt të Rregullores dhe as në dinjitetin tuaj, se, minimalisht, fjalën do të duhet t’ia jepni kujto deputeti.

E para, kur e kërkon në shqyrtimin e nenit përkatës dhe e dyta, kur e kërkon për votën kundër. Kaq kërkojmë ne. Ne nuk po pretendojmë që me fjalën tonë t’ju imponojmë ju të ndryshoni mendje, por ama kemi detyrim t’ju themi atyre që po dëgjojnë, njerëzve, qytetarëve, me të cilët ju do të bashkëqeverisni, meqë ra fjala, se nuk po u jepni të drejtën për të njohur ligjin e tyre, ligjin e bashkëqeverisjes. Ju nuk doni ta bëni. E bëjmë ne se e kemi ne për detyrim.

Kështu që, zonjë, të lutem, unë kam komente për çdo nen, jo në parim, për teknikë legislative, për përplasje nocionesh, për të gjitha. Do të më japësh të drejtën ta them këtë. Është vendim për ju. Po të doni, i merrni, i kapitalizoni, i përmirësoni, shumë mirë, dhe nëse nuk doni, ngrini dorën, ama të drejtën për të folur do të na e japësh. Këtë ftesë e kam për procedurë. Nëse do të votosh numrat, votoji.

Klotilda Bushka - Dakord. Faleminderit!

Kolegë, ju e dini shumë mirë procedurën dhe nuk e kuptoj pse sot po bëni sikur nuk e kuptoni.

Zonja Felaj, zoti Alibeaj, zoti Bylykbashi, a mund të mbani qetësi?

Keni nenin 4 për përpara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 3 u miratua.

Në nenin 4 kemi një riformulim, disa sugjerime për saktësim të teknikës legislative.

Fjalën e ka zoti Alibeaj, për nenin 4.

Enkelejd Alibeaj – Zoti Gogu, unë nuk do të doja të bullizoja askënd, por është e mira që me kolegët më të vjetër ju të kuptoni si zbatohet Rregullorja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqë nuk më dhe fjalën për nenin 3, po flas për nenin 4, por duke përfshirë edhe nenin 3.

Shiko çfarë keni përshkruar ju te neni 3, që e votuat.

“Fusha e zbatimit: Ky ligj zbatohet nga institucionet e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave”. E kuptoni çfarë keni shkruar? Jo ju, por kush e ka sjellë nga qeveria. Ju shkruani në ligj që ky ligj do të zbatohet. Është absurd logjik. Që nga momenti kur ligji miratohet, është i zbatueshëm. Nuk ka nevojë të shkruash një nen që ky ligj zbatohet. Kjo tregon jo seriozitetin dhe faktin që me këtë ligj nuk keni ndërmend të bëni asgjë më shumë sesa propagandë.

Për sa i përket nenit 4, pika 1, keni shkruar: “Grup interesi” (e keni harruar fjalën “është”, por keni vendosur presje), çdo organizatë jo fitimprurëse ... E kuptoni çfarë keni shkruar, apo jo? Domethënë, “grup interesi” është organizata jo fitimprurëse. E kuptoni ju ku është gabimi këtu? Kjo Republikë ka një ligj për organizatat jofitimprurëse, që është forma zyrtare e bashkimit të individëve. Ju thoni që “grup interesi” është organizata jofitimprurëse. Pak dinjitet profesionisti e ka ndonjëri (në këtë sallë besoj se mund ta kenë disa) nga qeveria që e thotë këtë gjë?

Më e rëndë është pika 2. “Koordinator” është një punonjës i Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje, i cili ushtron detyrën pranë një institucioni tjetër. Çfarë? Pra ky që qenka i punësuar tek Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje, bën edhe një detyrë të dytë tek institucionet? Çfarë janë këta njerëz të dypunësuar? Janë spiunë? Rrogën e marrin te Rama dhe punën e bëjnë tek institucionet e tjera? Më fal (u drejtohem atyre që mund të kenë paksa gjurmë në përvojën e tyre profesionale), si qëndron koncepti i dypunësimit me ligjin “Për statusin e nëpunësit civil”, që nuk e lejon, apo me Kodin e Punës? Këto dy ligje i rregullojnë marrëdhëniet e punës, ose njëri ose tjetri.

Si mundet që me një ligj të thjeshtë, që po e miratoni me vrap, 1, 2, 3, 4, 12 pro të tjerët kundër, po hidhni pas një ngrehinë të tërë legjislacionesh për të cilat janë hedhur para, siç janë ligji “Për statusin e nëpunësit civil” dhe Kodi i Punës? Për ligjin e statusit të nëpunësit civil është investuar vetë BE-ja. Është një nga kushtet e integritit, apo jo zonja Ministre? Është apo jo? Kodi i Punës. Kode, të cilat duhet të qëndrojnë, ju i hidhni pas me një palo ligj.

Pika 4. Këtu ka edhe probleme të analfabetizmit funksional. “Çështje” (fillon fjalia), përfshin të gjitha rastet që vijnë në seksionet e platformës. Fillon në njëjës, përfundon në shumës. Çfarë koncepti është kjo çështje që përfshin rastet. Cila mësuese gjuhe e fillores ia paska dhënë notën këtij që ka shkruar ligjin?

Pika 5. “Ankimi”, kërkesa për llogaridhënie nga institucionet apo punonjësit shtetëror për grupet e interesit, të cilët pasi kanë ndjekur procedurën dhe parashikimet ligjore nuk kanë marrë nga institucioni publik informacion. Zonja që kam përballë, së paku, bashku me mua ka bërë një barrë me shkollë për të kuptuar që koncepti “ankim” përdoret në Kodin e Procedurave Administrative, në Kodin e Procedurës Civile, në Kodin e Procedurës Penale, koncepte ligjore, të cilat janë të kalcifikuara.

Ju thoni “ankimi”. Çfarë ankimi? Jo, zonjë. Meqë po ma thua si pa mikrofon, ne këtu po diskutojmë ligjin që ka sjellë ministrja Spiropali, ndërkohë, zonjë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet ta qartësosh këtë, se ti as për këtë nuk na jep të drejtën ne. Atëherë, ne po gjykojmë dhe shqyrtojmë ligjin Spiropali apo ligjin Bushka?

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj, ju lutem, kursejini komentet që janë kundër etikës!

Enkelejd Alibeaj – Duhet t'i japësh të drejtën publikut dhe kujtdo të diskutojë.

Klotilda Bushka – Ju lutem, kursejini ironinë dhe çështjet që bien ndesh me etikën!

Enkelejd Alibeaj – Unë nuk e di fjalët “Spiropali” dhe “Bushka” të jenë terma fyes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me gjestë fyese, siç thotë zoti Gogu!

E fundit për këtë pikë. Deri tani, pesë nga gjashtë pika kanë probleme.

Pika 6. “Afate”, në kuptim të këtij ligji për shqyrtimin e ankesave ose çështjeve të paraqitura në seksionet e platformës “Me ty për Shqipërinë që duam” janë afatet për llogaridhënien e institucioneve shtetërore/punonjësve ...

A e di njeri andej nga qeveria që ka një Kod të Procedurave Administrative, që përcakton se cilat janë afatet mbi të cilat ndaj çdo ankese, jo ankimi, kërkesë, apo peticioni, meqë e përdor Kodi i Procedurave Administrative, duhet të japë përgjigje administrata? Si mundet që me një ligj të thjeshtë, i cili nuk respekton minimumi gjuhën shqipe, të kthesh pas Kodin e Procedurave Administrative?

(Diskutime pa mikrofon)

Pika 7. Interpelanca. Kjo është perlë. “Interpelancë”, takimi i zhvilluar midis qytetarëve dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave nëpërmjet platformës “Me ty për Shqipërinë që duam”. Më falni, e para, “interpelancë” është një term kushtetues dhe përdoret në Rregulloren e Kuvendit. Është e drejta e deputetëve dinjitozë t'u kërkojnë përfaqësuesve të qeverisë, dhe jo vetëm, të japin sqarime. Interpelancë? Çfarë doni të thoni me këtë? Po u jepni të drejta të mëdha publikut, që, siç bëjnë deputetët, të kërkojë edhe ai në interpelancë ministrat dhe Kryeministrin? Ty nuk të vijnë ministrat dhe Kryeministri në parlament në interpelancë, po u vikan qytetarëve!

Meqë ra fjala, zonja Ministre, pse nuk shkoni në interpelancë te banorët që po u prishen shtëpitë, në Laprakë? Kanë kërkuar interpelancë ata. Pse nuk u përgjigjeni? Kjo është tallja e madhe me projektligjin, me gjuhën shqipe, me konceptet juridike dhe kushtetuese. Do të thotë që jeni nga fillimi në fund thjesht dhe vetëm për propagandë. Ky ishte komenti që kisha për këtë nen dhe për nenin 3.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Zonja Spiropali, ju lutem! Ministrja e merr fjalën sa herë ta kërkojë, por para se ta merrni fjalën, zonja Spiropali, më duhet të sqaroj, të nderuar kolegë, dy çështje.

E para, u them kolegëve t’i referohen kolonës së tretë, e cila, jo nga unë si relatore, por me dakordësinë e nismëtarëve ka disa riformulime.

E dyta, ju tërheq vëmendjen, sepse, me sa shikoj, ju ligjin e keni parë jo në harmoni me të gjitha informacionet që ju janë dërguar nga sekretaria, me porosinë time si relatore, me sqarime të çështjeve dhe me informacion në lidhje me përputhshmërinë ligjit me Kushtetutën dhe me ligjet e tjera, por e keni kuptuar ose doni ta kuptoni sipas mënyrës suaj. Sigurisht, do të keni fjalën të thoni gjithçka, por ju nuk mund të merrni dot rolin as të gjykatës, as të Gjykatës Kushtetuese, nuk mund të bëni këtu as sikur jeni juristi i vetëm në Republikën e Shqipërisë dhe të shtrembëroni thelbin e asaj që thotë qëllimi i ligjit. Jam relatore dhe më takon t’ju bëj kundërshtime që kanë të bëjnë me thelbin e çështjes, sepse jam relatore, zoti Bylykbashi. Meqë na përmendi disa herë Rregulloren, lexojeni edhe ju Rregulloren.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Komentet e mia kanë të bëjnë me çfarë ju shtrembëroni nga ato që paraqiten në projektligj. Në të gjitha nenet që kemi kaluar deri tani projektligji ka qartësi të termave dhe përputhshmëri me Kushtetutën dhe ligjet e tjera, që ju i përmendët këtu. Juve mund të mos ju pëlqejë fjala “grup interesi” dhe pse qenka grupi i interesit një OJF. Ashtu është çmuar në ligj, sepse jemi ende te nenet e para. Kur të zhvillohen nenet më tej do ta shikoni se të tjera subjekte të shoqërisë kanë të drejta specifike në parashikimet e këtij projektligji.

Projektligji nuk dyzohet me Kodin e Procedurave Administrative, aspak, por parashikon një metodë inovative, që ka 4 vjet që përdoret nga qeveria. Është çështje e të kuptuarit. Ju e keni kuptuar gabim ose nuk doni ta kuptoni që në duart e qytetarëve ka mjete alternative, komplementare, që nuk u bien ndesh as parashikimeve të Kodit të Procedurave Administrative as ligjeve të posaçme. Janë çështje që lidhen me vonesa, mosveprim të administratës shtetërore, e cila, meqë ra fjala, është ajo që është në varësi të Këshillit të Ministrave. Këtu njësitë e pushtetit vendor futen në fushën e zbatimit të ligjit vetëm me vullnet dhe dëshirë të tyre, për të mos cenuar autonominë vendore. Kemi një sërë mekanizmash në ligj, edhe te platforma “Për Shqipërinë që duam”, edhe te parashikimet e neneve në vijim, të cilat lidhen të gjitha me nenet që sapo miratuam tani dhe ju i kundërshtuat.

Zonja Spiropali, keni fjalën për sa e kërkuat.

Elisa Spiropali – Kryetare, ishit shumë e qartë.

Unë dua të falenderoj të gjithë komisionin për kontributin që ka dhënë për këtë projektligj dhe posaçërisht ju si relatore e projektligjit që, në dakordësi me grupin nismëtar, ka ardhur me këtë produkt, i cili jo vetëm nuk u lexua këtu, por besoj se nuk është lexuar as para se të vihej në këtë komision.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pavarësisht teatralitetit të shquar të disa prej deputetëve këtu, të cilët unë i dëgjoj me ëndje, sepse më shijon toni dhe theksi, dua të theksoj që nuk u lexua...

Oerd Bylykbashi – Zonja Ministre, bëni kujdes kur flisni në Komisionin e Ligjeve.

Elisa Spiropali - Po ashtu, ju duhet të bëni kujdes kur flisni.

Klotilda Bushka – Të gjitha palët duhet të kenë kujdes. Zonja Spiropali, vazhdoni fjalën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elisa Spiropali - Ishte një kompliment, por si duket, së fundi, as komplimentet nuk i pranoni. Jeni shumë të shqetësuar.

Për sa u përket çështjeve që ju diskutuat këtu, si relatores, si kryetare dhe dakordësi, unë dëgjova që zoti Alibeaj i referohej një varianti të vjetër të ligjit dhe po diskutonte në parim, diskutime që ne i kemi ezauruar në diskutimin këtu në parim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Alibeaj, me gjithë respektin, kjo ishte ajo që diskutuat.

Unë e kuptoj që ju duhet ta bëni patjetër diskutimin tuaj këtu dhe mund të flisni edhe në seancë patjetër, e keni këtë të drejtë, madje flisni sa më shumë se është mirë që qytetarët t'ju dëgjojnë, por për sa i përket projektligjit, mund t'u referohemi ndryshimeve që janë bërë se ka qenë kontributi i përbashkët këtu ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë do të doja shumë të ishte ligji “Spiropali”, që nuk është, por jam krenare për grupin nismëtar. Pra, do të doja të ishte projektligji im.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të jeni i sigurt që është parë me vëmendje dhe janë dakordësuar për sa u përket ndryshimeve. Kanë qenë propozime edhe të grupit nismëtar, edhe të relatores dhe ka ardhur ky produkt, që besoj ia vlen të gjykohet kështu siç është sot për t'u kaluar ose jo në këtë komision të nderuar. Diskutimet e tjera nuk besoj se vlejné për këtu, por keni foltoren e Kuvendit.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Spiropali!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të nderuar kolegë, në kolonën e tretë, për ata që nuk e kanë të qartë akoma, keni riformulimet e neneve përkatëse me dakordësi të grupit të punës. Nëse ju nuk i keni parë tabelat dhe nuk i keni, jua vëmë në dispozicion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kemi çfarë të diskutojmë më, kemi procedurën.

(Debat pa mikrofon)

Zoti Alibeaj, nuk e di sa herë duhet t'ju them, sepse shpeshherë u referoni kolegëve, duke u thënë: “Jeni të vjetër dhe e dini Rregulloren”. Edhe ju jeni i vjetër dhe e dini Rregulloren. Keni marrë një email nga sekretaria e Komisionit të Ligjeve me njoftimin për mbledhjen. Keni një tabelë ku ju thuhet: në kolonën 1 ligji i ardhur, në kolonën 2 komente nga konsultimi publik, në kolonën 3, sipas nenit 71/1 të Rregullores së Kuvendit amendamentet e relatores. Tani, diskutoni mbi versionin e amenduar, sepse ju thashë që në fillim të mbledhjes kemi rënë dakord për këtë.

Enkelejd Alibeaj – A mund të flas për procedurës, se e kuptova?

Klotilda Bushka - Kini durim, sa ta fjalën mbaroj unë. Pse qenkeni me kaq pak durim? Ne ju kemi pritur gjithë ditën sot, tani ju kini durim, të marrim kohën e mjaftueshme.

Për nenin 4 që diskutuam, kishte koment për grupin e interesit, që jua shpjegova, kishte koment edhe për koordinatorin. Po, koordinatori është punonjës i agjencisë, i cili vendin e punës e ka në një institucion të administratës shtetërore, si personi që ndjek dhe koordinon të gjitha parashikimet e këtij ligji, sa u takon ankesave të qytetarëve apo çështjeve të tjera që do t'i trajtojë më vonë. Me kë? Me pikën e kontaktit që është punonjës i një institucion dhe kjo ka të bëjë me mënyrën e organizmit të informacionit, në mënyrë që çdo gjë të trajtohet dhe të mos mbesë më në ajër.

E gjithë logjika është që në nenin 4 kemi bërë disa riformulime të natyrës teknike, ku janë shtuar mbas çdo fjale, e cila merr një definicion, foljet “është”, “çfarë bën fjalë” apo “janë”.

Nga ana tjetër, më duhet t'ju shpjegoj, se terminologjia për grupin e interesit është shumë në rregull, në kuptim të këtij ligjit, pra është: “çdo organizatë jofitimprurëse që përfaqëson interesat e një grupi personash fizikë ose juridikë, si dhe subjekte të tjera të prekura apo të interesuara”, sepse ky është grupi i interesit në kuptim të terminologjisë që përdor ky ligj. Në zhvillimin e ligjit, në nene të caktuara do të shihni sesi edhe subjekte të tjera që kanë emërtime të ndryshme, jo grup interesi, kanë të drejta dhe detyrime.

Sa i takon fjalës “ankim”, është ndryshuar me fjalën “ankesë” në riformulim, në mënyrë që të mos kemi një mbivendosje të terminologjive dhe moskuptim të procedurave që parashikojnë ligje të tjera të posaçme dhe ky ligj. E kam shpjeguar edhe më parë, e keni të shpjeguar edhe në atë tabelën që do të doja ta kishit lexuar me vëmendje, që ky ligj parashikon proceduara komplementare, të cilat nuk bien ndesh me Kodin e Procedurës Administrative, por janë mjete plus në duart e qytetarëve për të adresuar ankesat e tyre në lidhje mosveprimin, me vonesat, e administratës shtetërore, njëra anë.

Ana tjetër, ka një nismë të gjerë, e cila përfshihet në disa rubrika dhe disa në mjete të vetë ligjit, siç janë “Nisma ime”, “Fjala ime”, “Kuvendimi ynë”, të gjitha këto do të trajtohen në çdo nen përkatës. Kjo ka bërë me atë që quhet “ndërveprimi”. Ndërsa termi “bashkëqeverisje” (se ju thoni që për çdo fjalë, duhet të ketë një bazë diku) në kuptimin literal (fjala bashkëqeverisje), do të thotë se nëpërmjet këtij ligji, nëpërmjet mjeteve që parashikon në çdo nen të vetin, sipas përcaktimeve përkatëse u jep mundësi qytetarëve të marrin pjesë, duke dhënë mendimi e tyre në nisma, të iniciojnë nisma, të thonë fjalën e tyre, të japin një vlerë.

Gjithashtu, nuk dyzohet as me ligjin “Për konsultimin publik”, se ligji “Për konsultimin publik” bën fjalë për nismat që vijnë nga qeveria apo organet publike dhe atje konsultohet me qytetarin, kurse ky ligj ka të bëjë kur vetë qytetarët duan të bëjnë një nismë. E para.

E dyta, nuk bie ndesh as me këtë ligj, nuk bie ndesh as fjala “interpelancë” që e ngrini këtu, sepse terminologjia që përdoret në ligje të caktuara, për këtë arsye futet në nenin e definicioneve, për të kuptuar se çfarë nënkuptimi ka, fjala që përdoret në këtë nen. Ja, kaq e thjeshtë është. Teatër dimë të bëjmë të gjithë, puna është t’i qëndrojmë strikt asaj që kemi në rend dite.

Dhe unë nenin 4, mbas diskutimeve, e hedh për votim, sipas formulimit.

(Debat pa mikrofon)

Ju folët për neni 4. Unë do ta ndaloj votimin, vetëm nëse ju keni riformulim. Nëse keni riformulim për nenin dhe doni të bëni një amendament, unë pa diskutim që jua jap fjalën.

Enkelejd Alibeaj – Po, kam amendament.

Klotilda Bushka - Urdhëroni!

Enkelejd Alibeaj – Do arsyet pastaj amendamentin apo amendamentin dhe më pas arsyet?

Klotilda Bushka - Si të duash.

Enkelejd Alibeaj – Amendament.

(Debat pa mikrofon)

Neni 4 të shfuqizohet. Arsyeja, është sepse i kam parë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Toni, në qoftë se nuk kërkon bulizim tani, vetëkufizohu, sepse është drejta e çdokujt që të ndërhyjë mbi përmbajtjen e ligjit. Ajo që unë dua të ndërhyj është që të shfuqizohet, sepse është i padobishëm për askënd. Pse?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja kryetare, a mund të kem komoditetin për të folur?

A mund t’i tërhiqni vëmendjen zotit Gogu, që të ketë respekt për tjetrin?

Toni Gogu - E kam shumë të lartë respektin...

Enkelejd Alibeaj – Atëherë, pse propozoj shfuqizimin? Sepse, e para, në pikën 1, ju thoni: “grup interesi çdo organizatë jofitmirurëse që përfaqëson interesat e një grupi”, më falni, është tautologji, për ata që se kuptojnë është të thuash të njëjtën gjë me fjalë të ndryshme. Grup interesi na qenka një organizatë fitimprurëse që mbron interesat e një grupi! E kuptoni këtë apo jo?! Ndërkohë, ajo që them unë, është kaq e thjeshtë.

Klotilda Bushka - Dakord, ju propozoni që ta heqim.

Enkelejd Alibeaj – Prit, moj zonjë, se nuk kam mbaruar me arsyet.

Pra, ta heqim me arsye, se do të jap arsyet. Kjo do të thotë, se me tautologji, ju po krijoni konfuzion në legjislacion dhe ligji i propagandës jo vetëm është i padobishëm, por jep impakte edhe te ligjet e tjera. E para kjo.

E dyta. I kam lexuar edhe komentet tuaja, zonjë, të jesh e sigurt për këtë, se unë kur i futem punës, i futem tamam, sepse dua të shoh edhe “ligjin Spiropali”, edhe “amandamentet Bushka”. Pse? Për procedurë, ta kuptojë edhe Toni, që kur diskutojmë në këtë Kuvend, diskutojmë materialin bazë, projektligji i sjellë nga qeveria, dhe për më tepër kur ka amendamentet i diskutojmë edhe ato. Pastaj në votim, ju i hidhni sipas radhës së amendamentit më të largët. Dakord!

Kështu që, është e padenjë që ministrja të vijë aty, të rrijë dhe të thotë: “Unë kam hequr dorë nga projektligji që kam miratuar, sepse e ka miratuar zonja Bushka”.

Klotilda Bushka - Jo, mos i shtrembëroni fjalët e ministres. Ajo tha: “Ne kemi rënë dakord me amendamentet, bashkë me relatoren”.

Enkelejd Alibeaj – I qëndron pra.

Kjo është drejtat e çdo deputeti, fillimisht të diskutojë për ligjin që ju keni sjellë, për “ligjin Spiropali” dhe pastaj për “amandamentet Bushka”. Kjo është rregullorja në një shtet të së drejtës, kur nuk ka bashkëqeverisje si puna juaj. Dakord! Ta kuptosh ti!

Këto janë të gjitha arsyet dhe amendamenti që propozoj unë. Heqja e gjithë nenin 4, sepse është sens. Janë koncepte ligjore të përdoruara në ligje të tjera dhe për më tepër, nën tentativën për t’i huazuar i keni deformuar,

Klotilda Bushka - Dakord, ky është mendim juaj zoti Alibeaj. Bëtë një amendament. Zoti Gogu, e doni fjalën përpara?

Toni Gogu – Po.

Klotilda Bushka - Për çfarë?

Toni Gogu - Për procedurë.

Klotilda Bushka - Po.

Toni Gogu – Zonja kryetare, po lexoj Rregulloren e Kuvendit: “Në rast se komisioni përgjegjës miraton në parim projektligjin, (kjo ka ndodhur në seancën e kaluar), ai fillon shqyrtimin dhe votimin nen për nen të tij”.

Fjalori i Gjuhës Shqipe: “shqyrtoj”, “shqyrtova”, “shqyrtuar”: këqyr diçka me kujdes e me hollësi për të nxjerrë një përfundim a për të marrë një vendim”.

Zoti Alibeaj, çdo shqisë, përveç gjuhës, mund të merrte pjesë në këqyrje, kështu që, zoti Alibeaj, me gjithë përpjekjet e tij, jashtëzakonisht të nderuara titanike, për të bërë një interpretim, që në fakt i takon Gjykatës Kushtetuese, mund të presë, nëse ka, ka edhe të fortë madje.

Zonja kryetare, kërkoj që të vazhdojmë votimin nen për nen, siç e kërkon Rregullorja dhe nëse zoti Aliebj, apo edhe zoti Bylykbashi, apo edhe ndonjë zotëri tjetër, do të shpjegojë votën kundër, në zbatimet Rregullores për 2 minuta, siç u tha edhe nga nënkryetarja, ta bëjë këtë punë.

(Debat pa mikrofon)

Klotilda Bushka - Zoti Gogu, mbaruat?

Toni Gogu – Po, mbarova.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Atëherë, sipas nenit 76, do të hedhim në votim propozimin e zotit Alibeaj, për të hequr nenin 4.

Kush është dakord? 8 vota pro për ta hequr nenin 4.

Kush është kundër heqjes së këtij neni? 12 vota kundër. Atëherë, nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

E hedhim në votim nenin 4 me formulimin e relatores. Pro? 12 vota pro. Kundër? 6 vota kundër.

Miratohet neni 4, sipas amendamentit të paraqitur nga relatorja.

Vazhdojmë me nenin 5. Parimi i pjesëmarrjes qytetare. Edhe këtu kemi një formulim të relatores për teknikë legjislativë.

Ka ndonjë propozim për amendament në lidhje me nenin 5?

Ermonela Felaj – Po, kam unë.

Klotilda Bushka – Po, zonja Felaj.

Ermonela Felaj – Zonja kryetare, mendoj të hiqet nga përmbajta e tekstit të këtij neni shprehja “gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative”, sepse ka një ripërsëritje brenda teksti, pra “e ushtrojnë veprimtarinë, gjatë ushtrimit të veprimtarisë”. Kjo shprehje të hiqet dhe të mbetet pjesa tjetër.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Ka propozim tjetër për formulim?

Po, zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet neni 5. Arsyeja? Çfarë keni shkruar ju te neni 5? Titulli “Parimi i pjesëmarrjes qytetare”. Përmbajta e nenit: “Institucionet e administratës shtetërore, si dhe çdo zyrtar publik e ushtrojnë veprimtarinë administrative duke nxitur ndërveprimin dhe pjesëmarrjen efektive qytetare gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative”. Çfarë do të thotë kjo? Me fjalë të tjera, fjalë shqip, kjo do të thotë se subjekteve, pra nëpunësve publikë për ta kuptuar, meqenëse është term kushtetues, u jepen disa detyra shtesë. Dhe çështja që shtroj për këdo është e thjeshtë, bazuar në ligjin “Për statusin e nëpunësit civil”, ata që kanë statusin e nëpunësit civil apo bazuar në Kodin e Punës, ata që janë në marrëdhënie pune prej Kodit të Punës, detyrat shtesë, shtohen në përshkrimin e punës dhe jo me ligj. Përshkrimi i punës është njëri nga nocionet e ligjit të “Për statusin e nëpunësit civil” për ata që janë me kontratë pune, në kontratë e punës, askush nuk ka të drejtë, në mënyrë artificiale, jashtë kësaj marrëdhënieje të shtojë detyra shtesë për nëpunësit e administratës, qofshin edhe këta militantë të Partisë Socialiste, që janë sot në administratën publike, qofshin këto edhe për ta. Do të thotë se me këtë ligj ju keni të drejtën t’u shtoni atyre detyra, “të nxisni ndërveprimin, pjesëmarrjen efektive qytetare gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative”, që nuk është gjë tjetër veçse: “Lër të gjitha punët e tjera merru me punët e partisë”.

Për këtë arsye, duke qenë se ky ligj bie ndesh me parashikimet absolute, të ligjit “Për statusin e nëpunësit civil”, i cili përshkruan detyrat e çdo nëpunësi publik apo me kontratën kolektive, individuale që rregullohet nga Kodi i Punës, bie ndesh edhe si ligj që miratohet me shumicë të thjeshtë, do të duhet të shfuqizohet, se është antikushtetues. Kaq.

Klotilda Bushka – Dakord.

Bëhet fjalë për nenin, 5 i cili flet për parimin e pjesëmarrjes qytetare.

Ne me grupin e punës kemi analizuar edhe legjislacionin “Për statusin e nëpunësit civil” dhe na rezulton që ligji nuk bie ndesh me të, sepse, siç e thamë, ndërveprimi me administratën shtetërore dhe qytetarët në këtë ligj, është në kuadrin e një veprimtarie komplementare për të drejtat e qytetarëve dhe në çdo rast këtu po flasim për parimet, se cilat janë detyrat e veçanta ato do të trajtohen në nenet e mëposhtëm. Gjithsesi, kemi dy propozime. Propozimi i zonjës Felaj, për të hequr një togfjalësh, sepse është i qartë dhe propozimi i zotit Alibeaj për ta hequr fare këtë nen.

Do të votojmë në fillim amendamentin, për ta hequr nenin. Kush është dakord? 7 vota pro. Kush është kundër? 12 vota kundër, për të mos e hequr nenin.

Bie amendamenti i zotit Alibeaj.

Atëherë, amendamenti i zonjës Felaj, do të bashkohet me amendamentin e relatores, për sa kohë bëhet fjalë për përmbajtjen e të njëjtit nen. Kush është dakord me përmbajtjen e nenit 5, sipas sugjerimit të relatores dhe sugjerimit të zonjës Felaj? 12 vota pro. Kundër? 7 vota kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 5, sipas formulimit të paraqitur nga relatorja dhe sugjerimit të zonjës Felaj.

Vazhdojmë me nenin 6. Parimi i rritjes së aksesit në shërbimet publike. Neni 6 parashikon parimin sesi duhet të punohet për të rritur aksesin e qytetarëve në shërbimet publike dhe është parim. Mënyra sesi ky parim zërthehet në ligj, është në nenet e mëposhtme. Tani, në nenin 6 kemi vetëm një ndryshim të teknikës legjislative, fjalët “nga çdo shtetas” të zëvendësohet me fjalët “ndaj çdo shtetasi”.

Ka propozime për formulime të tjera, amendamente nga kolegët?

Po, vazhdoni.

Enkelejd Alibeaj – Amendament, neni 6 të shfuqizohet. Arsyeja. Po lexoj nenin që ta kuptoni dhe pastaj do qeshni me veten. Titulli i nenit “Parimi i rritjes së aksesit në shërbimet publike”. Që kur lexon titullin fillon e mendon, kjo do të jetë ndonjë mundësi që do t’ju japë qytetarëve askes më tepër te shërbimet, t’i marrim më shpejt ato, në mënyrë më cilësor e të tjera. Fillon lexon nenin: “Institucionet e administratës shtetërore, në përputhje me kompetencat e tyre dhe në përmbushje të parimit të bashkëpunimit ndërinstitucional, duhet të garantojnë përfitimin e shërbimeve publike nga çdo shtetas, pavarësisht nga gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore”. Po e kuptoni se ç’është kjo? Kjo bën fjalë për mosdiskriminimin, është standard, nuk ka lidhje me aksesin në shërbimet publike. Titulli nuk ka lidhje fare me përmbajtjen. Nuk kam ndonjë problem me mosdiskriminimin si standard, se duhet të jetë. Më falni, po t’jua kujtoj, e kemi standard kushtetues, s’është nevoja ta vendosni në një ligj, se e rëndon, e kemi standard kushtetues.

E bukura pastaj, është kjo që tha zoti Bardhi, po të zbresësh dy nene më poshtë, titulli është “Trajtim i barabartë”, që duhet të ishte këtu. Domethënë, më poshtë titulli “Trajtimi i barabartë” duhet të ishte te neni 6, por përmbajtja këtu është mosdiskriminimi, kësaj i thonë të bësh një çorbë derri. Dhe ky është problem i madh, me një ligj që është demaskim, është demaskim i qëllimeve të bërjes së një ligji.

Nuk bëni asnjë punë, nuk u shërbeni qytetarëve, nuk i shpërbeni publikut për këtë arsye, meqë rrini kot, bëni një ligj kot.

Ky është arsyetimi që kam unë, që të shfuqizohet ky nen edhe të tjerët.

Klotilda Bushka – Atëherë, një sqarim për nenin 6, sepse zoti Alibeaj lexon vetëm atë pjesë për të cilën do të bëjë kërkesën për shfuqizim, por në fakt, nuk është kështu. Tani, meqenëse ju po mbani këtë qëndrim, unë do t’i lexoj të gjitha nenet një për një, që të jetë e qartë për qytetarët dhe që ky teatër të përfundojë.

Neni 6. Parimi i rritjes së aksesit në shërbimet publike, nuk do të thotë vetëm për çështjet e diskriminimit, por do të thotë që si t’i lehtësojmë qytetarët që të kenë më shumë akses në shërbimet publike, “në përmbushje të parimit të bashkëpunimit institucional, duhet të garantojë përfitimin e shërbimeve publike nga çdo shtetas, pavarësisht nga gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore, nëpërmjet procedurave administrative të thjeshta dhe transparente, të cilat nëpërmjet zgjidhjeve inovative e teknologjike mundësojnë një akses më të madh të qytetarëve në shërbimet publike”. Këtu mbaron.

Tani, ju mendoni ndryshe, ne mendojmë ndryshe.

Vazhdojmë hedhim në votim, sipas nenit 76 të Rregullores, propozimin e zotit Alibeaj, për ta hequr nenin. Kush është dakord? 6 vota.

Kush është dakord për të mos e hequr nenin. Pro? 11 vota pro. Abstenim nuk ka.

Atëherë, bie ky propozim, zoti Alibeaj.

Atëherë, vazhdojmë me hedhjen në votim të nenit 6, sipas riformulimeve të propozuara nga relatorja në bashkëpunim me nismëtarët. Kush është dakord? 11 vota pro. Kundër? 7 vota. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 6.

Vazhdojmë me nenin 7. Parimi i inovacionit të vazhdueshëm. Për nenin 7 do të bëj vetëm një sqarim, ku ka vetëm një shtesë, se çfarë nënkuptohet me fjalën “metodat inovative”. Pra, bëhet fjalë për metodat inovative të teknologjisë. Kjo lidhet me deregullimin e shërbimeve, që qytetarët të kenë akses online dhe të lehtësohen procedurat për ta.

Po jua them edhe një herë, bëhet fjalë për parim, se po ndalemi te parimet. Parimet duhet të jenë si bazë, në mënyrë që të zërthehen në nenet e ligjeve. Tani, mënyra sesi ju jeni kundër dhe keni mendimin tuaj, nuk paragjykohet në asnjë moment, por nuk do të thotë se ajo është mënyrë më e drejtë. Ne kemi mendimin tonë, të cilin e kemi shprehur në formë të shkruar, e keni edhe sqarimin përkatës.

Ju, keni formulime për amendamente?

Po, zoti Alibeaj.

Më parë e kërkon fjalën për procedurë, zoti Bardhi.

Gazment Bardhi – Zonja kryetare, ju po u referoheni shumë shpesh amendamenteve të relatores, në fakt, në bazë të Rregullores së Kuvendit, ju si relatorë duhej t’ia kishit paraqitur çdo anëtari të këtij komisioni relacionin bashkë me amendamentet përkatëse 48 orë para mbledhjes.

Vetëm dje secilit prej anëtarëve të komisionit i kanë ardhur 3 versione të ndryshme të këtij projektligji. Versioni fillestar; tabela që ka zonja para dhe ky versioni që na keni vënë sot para. Të tri versionet na kanë ardhur vetëm dje.

Ndaj, ju lutem, unë nuk isha në fillim të mbledhjes, do të duhej ta ktheni punën e këtij komisioni në punë komisioni, pra ju mund të ngrini grupe pune në Partinë Socialiste, sa të keni dëshirë, mund të punoni jashtë këtij komisioni, është e drejta juaj të përgatiteni e me radhë, por rregullat e funksionimit të komisionit do të duhet t’i respektoni.

Edhe për shkak të detyrave që kam përmbushur, munda ta bëj oponencën e ligjit për një orë, nuk kam nevojë për shumë kohë, por nuk po i hyj fare, se kjo është të tallesh me qytetarët, edhe cilësia e ligjit, edhe përmbajtja gjithashtu, dhe unë refuzoj të bëhem pjesë e këtij debati.

Rregullorja thotë: “48 orë përpara” dhe do të duhet që zonja relatore, meqenëse e paska me shumë qejf këtë amendament, të na paraqesë relacionin, së bashku me amendamentet përkatëse, jo 10 orë para se të zhvillohet mbledhja.

Klotilda Bushka – Zoti Bardhi, është i kotë ky diskutim. Unë ua kam thënë edhe në mbledhjen e kaluar që nuk jam si ata kolegë që ju tregojnë “të lexoni Rregulloren, se jeni të rinj”, sepse mendoj se këtë koment për Rregulloren “48 orë para” e keni të pabazuar në asnjë nen të saj.

Jemi komision përgjegjës për shqyrtimin e këtij ligji dhe, kur bëhet shqyrtimi në komisione, amendamentet paraqiten edhe në momentin kur bëhet shqyrtimi nen për nen, ashtu siç po e paraqet edhe zoti Alibeja, neni 71 i Rregullores.

Sa për dijeni, ju e keni marrë versionin me amendamentet e relatores, të dakordësuara me nismëtarët, 1 ditë para mbledhjes dhe i keni sqarimet në tabelën e paraqitur. Kështu që ky komenti juaj për procedurë nuk qëndron. Mos u ngatërroni që amendamentet e ligjit “48 orë para” paraqiten kur ligji shqyrtohet në seancën plenare dhe jo në komisionin përkatës.

E lëmë debatin për procedurë, se është i qartë, të gjithë anëtarët e komisionit e dinë. Ju e keni pasur tabelën, i keni pasur në kohë, madje edhe mund të mos i kishit, se mund t’jua jepja edhe sot në komision, por jua kam nisur më parë, pasi puna ishte e mbaruar, pra që të kishit kohë ta shikonit, ashtu sikurse zoti Alibeja është duke folur për ato çështje, sepse e ka marrë tabelën, sikurse edhe anëtarët e tjerë të komisionit.

Për ta vazhduar ku e lamë, zoti Alibeja, keni ndonjë riformulim për nenin 7?

Enkelejd Alibeaj – Që është shkelje ajo që ngriti zoti Bardhi, është shkelje...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Zoti Bardhi, do ta lini zotin Alibeaj të mbarojë fjalën?

Zoti Alibeja, keni fjalën.

Enkelejd Alibeaj – Mirë është që gjërat t'i lexojmë dhe të mos bulizojmë askënd, siç nuk bëmë ne me kolegun tuaj, aq më tepër pastaj, kur gjendeni në situata jo të këndshme edhe për ju deputetët e vjetër, sepse përgënjeshtrohen menjëherë. Shiheni dhe lexojeni edhe një herë. Është në nderin e çdo deputeti që, të paktën ta respektojmë procedurën, se vota dihet fare mirë se ku është.

Lidhur me nenin 7, amendament, të shfuqizohet. Çfarë përmbajtje ka, se të paktën këtë do të duhet t'ua bëjmë të ditur njerëzve? “Parimi i inovacionit të vazhdueshëm”, e kanë titulluar. Institucionet e administratës shtetërore nxisin përdorimin e metodave inovative për ndërveprimin me grupet e interesit dhe çdo qytetar, me qëllim zhvillimin e ideve dhe bashkëkrijimin e zgjidhjeve për mirëqeverisjen e vendit duke përdorur mundësitë që krijohen nga platformat elektronike qeveritare, duke përfshirë përdorimin dhe publikimin e të dhënave sipas parimit të qeverisjes së hapur.”.

Me fjalë të tjera, parim në një lig që miratohet nga qeveria, vjen në Kuvend te Komisioni i Ligjeve... U thoni njerëzve hapeni dhe merruni me *TikTok*-un. Ky është parimi i novacionit me *Facebook* e këto gjëra. “Parimi i inovacionit”, injektoni te njerëzit që të merren me aplikacione. Në fakt, ka një gjë të dhimbshme në këtë mes, sepse metodat inovative ishin ato të përdorura për patronazhistët, dhe këtu bëhet serioze gjëja; metodat inovative. Në fakt, ky ligj, siç e kam thënë edhe në diskutimin në parim, ka vetëm një dobi, jo për qytetarët, por për qeverinë: vjeljen e të dhënave personale dhe halleve të njerëzve nëpërmjet metodave inovative, pra kush ka hall te legalizimet, kush ka hall te kadastra, kush ka hall te dëmshpërblimi për tërmetet, kush ka hall për punësimet. Të ngratët shqiptarë, me metoda inovative gjithmonë, ia paraqesin këto halle qeverisë, qeveria mbledh të gjitha të dhënat personale, hallin e tyre dhe, kur vjen dita e zgjedhjeve, hyn në fuqi ky ligj “o me kulaç, me para, o me kërbaç”. Ja, pra, ky është qëllimi final i këtij projektligji, asgjë më tepër, me metoda inovative.

Ndaj, do të duhet shfuqizuar një orë e më parë, sepse kjo është çështja e patronazhistëve dhe tallja me shqiptarët është bërë problem i madh në zgjedhjet e 25 prillit.

Ndaj, do të duhet shfuqizuar dhe do të duhet të dalin të turpëruar, duke filluar nga qeveria dhe ju të tjerët nga kjo histori.

Klotilda Bushka – Zonja Spiropali e ka kërkuar fjalën, por, ju lutem, fokusohuni te rendi i ditës. Po të doni të flisni për këto çështje, keni komisionin hetimor, ku mund t’i ezauroni, sepse e keni të gjithë mundësinë.

Te neni 7, më falni, zonja Ministre “Parimi i inovacionit të vazhdueshëm”, ndoshta nuk është i qartë për ju, por parimet dhe i gjithë synimi i shumicës është që të shkojmë sa më shumë në përdorimin e teknologjisë së informacionit për shërbimet publike.

Ky parim, pikërisht, këtë nënkupton. Qytetarët pa diskutim, do të marrin më shumë shërbime *online* dhe ne do ta rrisim aksesin e tyre në këto shërbime. Ky është thelbi i nenit.

Çështjet e tjera, që janë çështje që lidhen me problematika të patronazhistëve apo të kujt jeni duke përmendur sot këtu, i keni të gjitha mundësitë t’i sqaroni deri në fund tek ai komisioni tjetër, ku edhe jeni kryetar.

Zonja Spiropali, fjala për ju.

Elisa Spiropali – Ne nuk kërkojmë ndjesë që besojmë te parimi i inovacionit të vazhdueshëm, sepse besojmë se revolucioni dixhital që ka nisur dhe po aplikohet, lufton korrupsionin, jep shërbime më të mira dhe kjo është e provuar. Në çdo raport për Shqipërinë theksohet digjitalizimi.

Kërkojmë ndjesë që nuk mund të kthehemi dhe nuk do të kthehemi te standardi i “Shaban tapisë” apo “Alo, doktor, denoncoj korrupsionin”. Na vjen shumë keq, por, si koha, si standardet, si vullneti ynë është i fortë për të ecur në këtë drejtim.

Besoj se neni këtu është shumë i thjeshtë, se është thjesht renditja e një parimi, i shprehur qartë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Ka ndonjë riformulim tjetër për nenin?

Atëherë kalojmë në votim. Do të votojmë në fillim propozimin e zotit Alibeaj për ta hequr nenin. Kush është pro? Kundër? Abstenim? 4 vota pro. 12 vota kundër. Abstenim nuk ka.

Ky propozim nuk kalon.

Vazhdojmë te miratimi i nenit 7, sipas propozimit të dakordësuar midis relatores dhe nismëtarëve. Kush është pro? Kundër? Abstenim? 12 vota pro. 4 vota kundër. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 7.

Neni 8 “Parimi i bashkëpunimit ndërinstitucional”. Këtu nuk ka ndryshime. Do të kalojë sipas versionit të sjellë nga nismëtarët. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

(Ndërrhyrje pa mikrofon.)

Keni propozime, zoti Alibeaj? Do të bëni propozim ta hiqni sërish? Për çdo dispozitë do të merrni fjalën për shfuqizim?

(Diskutim pa mikrofon.)

Zoti Alibeaj, do ta prezantoni amendamentin?

Enkelejd Alibeaj – Neni 8 “Parimi i bashkëpunimit ndërinstitucional”. Ju nuk e lexuat, ndaj do ta bëj unë, se është e mira ta lexoni për bashkëqeverisjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ta shfuqizojmë këtë nen, Xhemal.

“Institucionet e administratës shtetërore koordinohen nëpërmjet mekanizmave të posaçëm institucionalë për zhvillimin e praktikave të mira dhe përdorimin e tyre në të gjithë administratën shtetërore, për gjithëpërfshirjen e çdo qytetari në politikëbërje, për garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative vendimmarrëse dhe për rritjen e përgjegjshmërisë dhe të llogaridhënies së administratës shtetërore”. Një nen, me një fjali, ne nuk respektojmë rregullat më minimale të gjuhës. E para, Xhamal.

E dyta...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ua them unë si të formulohet. Siç thuhet në Dhiatën e Vjetër “Fjala është e para”, tani po them gjë tjetër që në nenin 8, dhe ky nuk është bulëzim, por është thirrje ndaj dinjitetit njerëzor në këtë mes, shiko çfarë keni thënë ju me këtë: “Në një shtet të së drejtës ka një rregull që funksionon në bazë të atyre që quhen “përgjegjësi të ndara” dhe komunikimi midis individit dhe shtetit bëhet nëpërmjet të drejtave dhe detyrimeve”, nuk ka bashkëpunim. Çfarë do të thotë bashkëpunim? Do qeveria, të jep të drejtën, s’do qeveria, s’ta jep të drejtën? Ligji e përcakton, e drejta e përcakton. Ky thotë: “parimi i bashkëpunimit ndërinstitucional”.

Domethënë, kadastra dhe ALUIZNI, kur vjen puna e zgjedhjeve, bëhen shumë bujarë me qytetarët, madje shkojnë ua japin lejen e legalizimit të shtëpia të ngratëve shqiptarë. 4 vjetët e tjera, meqë nuk ka bashkëpunim, këtë u japin qytetarëve, por nuk duhet të jetë kështu në shtetin e së drejtës. Ju, jo vetëm e bëni, por keni edhe fudullëkun për ta shkruar në ligj. E kuptoni çfarë nivelesh marrëzie keni arritur?!

Mos heshtni!

Jepni përgjigje! Xhemal, nga ty do ta doja një përgjigje, si më i vjetri.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj, nuk mund të jetë arsytim i propozimit që bëni duke u thënë kolegëve “merruni, përfshihuni”. Formulimi juaj duhet të ketë një arsytim për amendamentin, jo një fjalim politik.

Që ta dini, zoti Alibaj, po jua jap unë përgjigjen, parimi i bashkëpunimit ndërinstucional është një parim shumë i rëndësishëm dhe ky parim që thuhet në këtë pjesë të projektligjit...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, uleni fudullëkun dhe mënyrën se si jeni duke u sjellë, se ne e kemi shumë seriozisht këtë punë dhe nuk kemi ardhur për teatër se kush do të mbajë garën deri më 11 nëntor, këtu jemi duke miratuar një projektligj, i cili fuqizon qytetarin dhe sigurisht që institucionet e administratës shtetërore do të merren së bashku dhe do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën si të rrisin mekanizmat eficientë të këtij bashkëveprimi.

Juve nuk ju pëlqen, se ne po fuqizojmë qytetarin. Po unë nuk e di çfarë bënit ju në kohën tuaj “Alo, doktor, apo më merr mua në telefon?”.

Lëri këto diskutime!

Do të hedh në votim tani propozimin e zotit Alibeja për ta hequr nenin. Kush është pro? Kundër? Abstenim? 11 vota kundër.

Ky propozim bie.

Kush është dakord të kalohet neni 8 sipas variantit të depozituar nga nismëtari? Kush është pro? Kundër? Abstenim? 11 vota pro. 4 vota kundër.

Vazhdojmë me nenin 9.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë numëroj duart që ngrini ju. Ka edhe kamera këtu, zoti Bardhi. Të jesh i sigurt që unë i numëroj shumë mirë. Në qoftë se nuk e kishit mendjen, kini mendjen dhe votojeni!

Neni 9 “Parimi i kontrollit”. “Veprimtaria administrative përveç kontrollit administrativ ose kontrollit gjyqësor i nënshtrohet edhe kontrollit, sipas parashikimeve të këtij ligji”.

Këtu ka vetëm një amendament që është për teknikë legjislativë, të paraqitur nga relatorja në dakordësi me nismëtarët. Më duhet t’ju sqaroj se nga komentet e ardhura dhe në diskutimet me grupin e punës “kontrolli”, sipas këtij projektligji është, kuptuar gabim. Është sqaruar në tabelën e paraqitur, zoti Bardhi, se ky kontroll është një instrument plotësues suplementar, jo si një instrument që zëvendëson apo konkurren ato instrumente të Kodit të Procedurës Administrative apo ligje të tjera.

E parë kjo nga këndvështrimi i qytetarëve, ky është një mjet fakultativ. Po bëj unë një sqarim si relatore, sepse kemi pasur diskutim në grupin e punës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po ta keni mendjen, zoti Alibeja, do të më kishit dëgjuar që e lexova amendamentin tim dhe tani jam duke dhënë sqarimin.

Pra, e lashë te fjala që kemi të bëjmë me një mjet komplementar, fakultativ që i lihet në dorë qytetarit, tej procedurave të Kodit të Procedurës Administrative apo ligjeve të tjera të posaçme për të kërkuar të drejtat e veta dhe lidhen kryesisht me raste që kanë të bëjnë me mosveprim të administratës apo me vonesa. Në asnjë dispozitë të këtij ligji agjencia nuk ngarkohet të kryejë shqyrtim administrativ apo të marrë kompetenca të tilla. Kjo është një kompetencë që do të vijojë të ushtrohet normalisht nga organet e tjera administrative në përputhje me Kodin e Procedurave Administrativ dhe ligjet e posaçme.

Agjencia, nëpërmjet kontrollit që parashikon ky projektligj, do të ketë thjesht mundësinë për të garantuar që organet administrative nuk do të neglizhojnë shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve.

Një sërë veprimtarish të tjera vijnë në kuadër të vet mekanizmave të ligjit, që kanë të bëjnë me çështje që nuk janë ankesa, siç janë: “Modelet e kuvendimit tonë”, “Nisma ime”, “Shkolla ime”, “Nota ime” e të tjerë.

Pra, me pak fjalë, ka edhe një rubrikë në platformë që është “Vota ime”, e cila voton shërbimet që kanë dhënë organet e administratës shtetërore.

Në fund të ditës, dua t’ju sqaroj se ky është i vetmi sqarim në formulimin që unë kam paraqitur, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj.

Ka diskutime për riformulime?

Po, zoti Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Së pari, pasi keni shtuar në ligj 10 parime, që konkurroni edhe me organizatat e mëdha, ku thoni: “sipas rregullave dhe procedurave”. “Sipas parashikimeve të këtij ligji” – thonë ata.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Komiteti Shqiptar i Helsinkit thotë (në këtë nen përcaktohet parimi i kontrollit): “Vlerësojmë se nuk do të ishte e drejtë që të përcaktohen llojet e kontrollit”. Ju thoni: “U dhamë përgjigje” dh, në fakt, kur të zbatohet ky ligj, nuk do të zbatojë njeri çfarë keni shkruar ju te përgjigjja për Helsinkin, por çfarë do të lexojnë ata dhe si do të konfuzionohen ata, do të bëjnë edhe pazar, madje nëse do të përdorin këtë procedurë apo atë tjetrën.

Megjithatë, shikoni ç’thuhet te raportit i Komitetit Shqiptar të Helsinkit: “Çdo procedurë vepron dhe kontrollon në bazë të kompetencave që i jep ligji, për ligjet me shumicë të cilësuar dhe ligjet organike të institucioneve, në rastet kur kanë epërsi. Në këtë situatë do të krijohej një mbivendosje kompetencash që mund të cenonte parimin e sigurisë juridike, që është parimi kushtetues dhe qartësisë që ligjit, rrjedhimisht edhe efektivitetit të zbatimit të tij në praktikë.”.

Pra, mirë që do t'i priset efektiviteti, siç thotë Komiteti i Helsinkit, por do të priset efektiviteti i ligjeve të tjera.

Ja ku është edhe një palë tjetër, përveç palës sonë këtu, që nuk e sheh si ju me kaq poezi këtë ligj, por e sheh me shqetësim për cenimin e parimeve kushtetuese të shtetit të së drejtës, sigurisë juridike, harmonisë së normave me njëra-tjetrën dhe epërsisë së tyre.

Me një përgjigje të lehtë, ju thoni: “S’ka problem, se e kemi zgjidhur”, por, kur ta marrin në dorë ata komisarët që do të çoni tek të gjitha institucionet dhe të shkojnë ta bëjnë rrëmujë procesin e kontrollit administrativ, nuk do të dijë njeri ta lexojë këtë që keni shkruar këtu si përgjigje, por do të lexojë atë nenin që është shkruar me këtë përmirësimin, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë ligj.

Klotilda Bushka – Zoti Bylykbashi, nuk kishit formulim?

Oerd Bylykbashi – Edhe një herë po ju them se edhe të tjerët e shohin njësoj, siç e shohim ne.

Klotilda Bushka – Një sekondë, se ju bëra pyetje tjetër.

Komentet e konsultimit publik, dua t’ju sqaroj se janë komente konstruktive, të cilat, në fakt, jo vetëm në këtë procedurë parlamentare, por në çdo procedurë tjetër parlamentare, kur ne shqyrtojmë ligje, sjellin komente, të cilat janë shumë të rëndësishme për të përmirësuar.

Ne jemi të hapur dhe nuk kemi komplekse pse dikush bën një kritikë. Pa diskutim, gjërat mund të përmirësohen.

Ne nuk e kemi kompleksin e nxirjes apo të të hedhurit baltë për diçka, sepse këtu jemi për interesin më të mirë të qytetarëve dhe çdo koment është i mirëpritur. Sigurisht, komentet dashamirëse, jo ato që shtrembërojnë thelbin.

Ju, zoti Bylykbashi, lexuat komentin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, në të cilin, në kolonën e dytë të tabelës ka një sqarim shterues, që do të zërthehet edhe më tej në nenet përkatëse, sepse pikërisht ky ka qenë shqetësimi.

Në pikën e parimit është ngritur shqetësimi se mos kemi një mbivendosje të dy kontrolleve. Qartësisht, është dhënë sqarimi pse nuk kemi mbivendosje të të dyja kontrolleve, dhe kemi thënë: “Në asnjë dispozitë të projektligjit, Agjencia nuk ngarkohet të kryejë shqyrtimin në themel të ankimit administrativ”, por do ta themi te neni përkatës, jo këtu.

Sa për dijëni, ku sqarohet kjo gjë. Në raportin e projektligjit çdo pikë e diskutimit të konsultimit publik do të jetë e cituar një më një: çfarë u ngrit, si u sqarua, çfarë u adresua, sepse ne nuk e kemi problem transparencën, nuk i kemi problem kritikën, pasi këtu jemi në interes të qytetarëve, jo për të marrë flamuj se cili është më i zoti, apo jo.

Zoti Alibeaj, për formulim.

Enkelejd Alibeaj – Se kush bën komente dashamirëse apo jo, këtë nuk mund ta thotë asnjë nga ju, aq më pak ju.

Kursejani vetes këtë gjë!

Ti ke vetëm një detyrimin: t'i japësh kohën e fjalës secilit kur e kërkon, sipas Rregullores.

Klotilda Bushka – Unë jam edhe relatore.

Sot kam dy cilësi dhe kam të drejtë t'ju kundërshtoj për ato që thoni.

Enkelejd Alibeaj – Ju mund të keni edhe tri cilësi, por mbi fjalën time apo të kolegëve të mi, nuk ke asnjë të drejtë. Ti mund të ...

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj, do ta vazhdoni fjalën për riformulim? Gjithmonë thoni: “Bëni si them unë...”

Ju lutem!

Enkelejd Alibeaj – Do ta vazhdoj dhe më dëgjoni!

Klotilda Bushka – Nëse doni të na tërhiqni vëmendjen, silluni ju i pari njësoj për kritikën që na bëni ne.

Enkelejd Alibeaj – Nuk jeni e detyruar të jepni asnjë koment për amendamentin tim dhe nuk ke asnjë të drejtë t'ua kërkosht kolegëve këtë gjë.

Amendament: Të shfuqizohet togfjalëshi i fundit, i cili fillon pas presjes “i nënshtrohet edhe kontrollit, sipas parashikimeve të këtij ligji”.

Ky ishte varianti i Spiropalit.

Varianti Bushka është: “I nënshtrohet edhe kontrollit, sipas rregullave dhe procedurave të këtij ligji”.

Fjalën “parashikimeve” e ke zëvendësuar me togfjalëshin “rregulla dhe procedura”.

Asgjë, tautologji. E gjitha duhet të bjerë.

Kjo nuk është lojë. Pse? Sepse, siç janë demaskuar këta të qeverisë, por edhe ju vetë, në nenin 9 parashikohet ajo që thuhet në Kushtetutë: “Administrata shtetërore kontrollohet, monitorohet, inspektohet, mbikëqyret, vetëm me dy rrugë: kontrolli administrativ vertikal i brendshëm, i përcaktuar në ligjin “Për statusin e nëpunësit civil apo në ligjin “Për administratën shtetërore”; kontrolli i dytë është gjyqësor. Çdo instrument tjetër kontrolli, është kontroll politik. Ju po e shtoni në këtë ligj, por është kontroll politik, sepse politizon administratën.

Një nga kushtet që Europa i kërkon këtij vendi është depolitizimi i administratës, i cili kryhet duke respektuar nenin 107 të Kushtetutës, që nëpunësit publikë rekrutohen me konkurs, zbatojnë ligjin dhe janë të pavarur nga urdhrat politike të administratës.

Po kështu, edhe kontrolli gjyqësor.

Së fundi, kjo gjë bie ndesh edhe me një dispozitë tjetër kushtetuese, nenin 102, pika 4, të Kushtetutës, ku thuhet: “Kontrolli administrativ i brendshëm...”, ai që unë thashë i pari, “...bëhet nga ministrat...”, nuk bëhet as nga Kryeministri.

Pse e ka vendosur Kushtetuta? Sepse ministri është figurë politike, votohet dhe përballet, siç ka ardhur zonja, që lexon celularin.

Ndërkohë, çfarë bëni ju? Ju kaloni një agjenci, që askush nuk e di pse, të cilën e zhvat dhe e centralizon Kryeministri; që nuk bën gjë tjetër, veçse atë që tha një nga kolegët, qeveri private të Kryeministrit, duke spostuar edhe vetë ministrat. Nuk na hapet barku shumë për ministrat, por Kushtetuta thotë se ministrat mbajnë përgjegjësi. Kuvendi ekziston me debatin e vetë parlamentar, sepse thërret dhe kontrollon qeverinë.

Ndërkohë, drejtori apo drejtoresha e kësaj agjencisë, nuk ka për të ardhur asnjëherë këtu. Puna e vetme, që ka bërë nën sqetullën e Kryeministrit, është thjesht dhe vetëm të përcaktojë dhe të vendosë në jetë mekanizmin e patronazhimit.

Kjo është e gjitha, ndaj duhet shfuqizuar, sepse është antikushtetuese.

Klotilda Bushka – Dakord, shumë e qartë.

(Diskutime pa mikrofon)

I gjithë sqarimi që sapo dha zoti Alibeaj vlen nëse ligji në këtë nen do të parashikojë parimin e kontrollit administrativ, por bëhet fjalë për një kontroll tjetër, që është tej kontrollit administrativ, dhe bie poshtë i gjithë formulimi.

(Diskutime pa mikrofon)

Do ta hedhim në votim formulimin e zotit Alibeaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Gogu, jam duke e hedhur në votim.

Bëhet fjalë për nenin 9, me propozimin e zotit Alibeaj, për të hequr fjalinë “I nënshtrohet edhe kontrollit, sipas parashikimeve të këtij ligji”. Kush është dakord? 5 veta dakord. Kundër? 11 veta kundër. Abstenim? Nuk ka.

Bie poshtë ky propozim.

Kush është dakord me nenin 9, sipas formulimit të relatores, së dakordësuar me nismëtarët? 11 pro. Kundër? 6 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Vazhdojmë me nenin 10, “Parimi i trajtimit të barabartë”.

Neni 10 është në formën e paraqitur nga nismëtarët, nuk ka amendamente.

“Institucionet e administratës shtetërore i garantojnë çdo qytetari ose grupi interesi mundësi të barabarta dhe të drejtën për të propozuar, për t’u informuar, për t’u konsultuar, si dhe pjesëmarrjen në të gjitha fazat e konceptimit, hartimit të nismave, që kanë si qëllim

përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike, deburokratizimin dhe rritjen e eficiencës së administratës shtetërore”.

Neni 10 është në kontekstin e proceseve, që kanë karakter rregullator, që do të thotë: nisma për ligje, vendime me karakter normativ dhe jo akte administrative, që kanë karakter individual.

A keni propozime për riformulim?

Zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Arsyeja është fare e thjeshtë.

Këtu thoni: “Parimi i trajtimit të barabartë”.

Në shqipe, të varfër madje, do të thotë “mosdiskriminim”.

Ndërkohë, mosdiskriminimi është vendosur në dy nenet e mësipërme, siç edhe e thashë.

Mos shtoni shkronja të zeza në ligj, sepse kjo nuk nënkupton që po punoni shumë. Të paktën, të kurseni bojën.

Të shfuqizohet!

Klotilda Bushka – Neni 10 flet për parimin e trajtimit të barabartë, ndërkohë që neni 6 flet për zgjidhjet inovative, të cilat i duhen dhënë çdokujt, pa diskriminim. Ndajeni!

Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj për ta shfuqizuar, për ta hequr këtë nen? 6 pro. Kundër? 11 kundër. Abstenim? Nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 10, sipas propozimit të ardhur nga nismëtarët? 11 dakord. Kundër? 6.

Neni 11, “Strukturat shtetërore përgjegjëse për bashkëqeverisjen”.

Në nenin 11 propozohet të hiqet një paragraf, i cili thuhet në pikën 1 të nenit të riformuluar, dhe i gjithë neni do të jetë më i shkurtër. Do të thuhet vetëm: “Strukturat shtetërore përgjegjëse për bashkëqeverisjen do të jenë Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje dhe institucionet e administratës shtetërore”. Kush është dakord me këtë nen?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 11.

Vetëm strukturat.

11 pro.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 11 ka vetëm strukturat. Çfarë do të ndryshojmë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është vetëm shpalosja e institucioneve.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Alibeaj!

Enkelejd Alibeaj – Më jep të drejtën e fjalës!

Se çfarë flas, e di unë.

Klotilda Bushka – Meqenëse e hodha në votim dhe ky nen u miratua, do t'ju jap të drejtën të shprehni votën kundër.

Enkelejd Alibeaj – Kërkoni falje që nuk e respektoni procedurën!

Klotilda Bushka – Jo, nuk ju kërkoi falje, sepse ju duhet të kërkoni falje gjithë ditën për atë që e keni shkelur sot procedurën.

Unë nuk e kam shkelur procedurën. Mendova se ky është një nen që flet vetëm se cilat janë institucionet dhe thashë, ka apo jo mendime.

Enkelejd Alibeaj – Mos mendo, sepse ta kam thënë gjithmonë, që unë, për çdo dispozitë, kam një amendament.

Klotilda Bushka – Nuk pashë të kishit amendime, sepse po bisedonit me njëri-tjetrin. Kini mendjen kur drejtoj unë mbledhjen!

Enkelejd Alibeaj – Domethënë, e shikoni vetëm nga njëra anë.

Klotilda Bushka – Jo, të jeni të bindur se këta nga ana ime e majtë, janë persona shumë të vëmendshëm, e marrin fjalën për çështje që kanë thelb, nuk e shtrembërojnë faktin dhe nuk kanë asnjë hall për datën 11 nëntor, që të dalin kaq mirë.

Ju lutem, sepse ndoshta i hyjmë në hak për të drejtën e fjalës anës së majtë, duke ju dhënë fjalën juve.

(Diskutime pa mikrofon)

A keni riformulime për nenin 11?

Doni të shtoni ndonjë institucion tjetër në nenin 11, përveç atyre që kemi propozuar, zoti Alibeaj?

(Diskutime pa mikrofon)

Enkelejd Alibeaj – Në kohën time, mos harxho frymë!

Për kolegët, që po eksplorojnë metodat inovative, ndërkohë që po diskutojmë një projektligj të rëndësishëm, mirë është t'u tërheqësh vëmendjen! Jo të rrinë gjithë kohën në celular!

Mos shikoni ministren, sepse ata, atë punë kanë!

Ju jeni deputetë.

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj, vazhdoni të drejtën që keni për formulim!

Tërheqjen e vëmendjes ua bëj unë të gjithë anëtarëve në këtë mbledhje.

Ju lutem!

Enkelejd Alibeaj – Juve jua drejtova, që t’ia drejtoni qeverisë dhe kolegëve.

Amendament: të shfuqizohet, sepse keni vendosur, qoftë me nenin e gjatë, edhe me nenin e shkurtër, një gjë shumë të rëndë.

Ju thoni: strukturat shtetërore përgjegjëse për bashkëqeverisjen, që do të thotë..., dhe nënkupton që kontrollin mbi administratën ta bëjë Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje. Domethënë, të mos e bëjë më Spiropali, por ta bëjë kjo vajza këtej. Kam përshtypjen se kjo do të drejtojë agjencinë.

E kuptoni çfarë po thoni? Kjo do të thotë se u hiqni të drejtën ministrave. Ju thashë edhe më parë, nuk kam asnjë merak, por si figurë kushtetuese, të mbajnë përgjegjësi, sepse neni 102, pika 4, i Kushtetutës ngarkon ministrin të mbajë përgjegjësi për fushën që drejton, për ministrinë që drejton dhe për ndërveprimin me qytetarët. Pra, u shërben qytetarëve.

E kuptoni se çfarë bëni me këtë ligj? Ndryshoni Kushtetutën. I jepni të drejtën për të kontrolluar, për t’i prerë veshin dhe kokën administratës, një dore të padukshme politike, që emëron Kryeministri. Të gjithë këta të tjerët janë vetëm rrotaçile, që nuk i respekton askush.

Është rregull kushtetues, ndaj duhet shfuqizuar për të ruajtur fytyrën tuaj këtu, lërinin ata të qeverisë. Ky është arsyezim kushtetues.

Klotilda Bushka – Po, zoti Qefalia.

Xhemal Qefalia – E kërkova fjalën disa herë, por mendoj se komisioni nuk po kthehet në rendin e ditës.

E tha zoti Gogu, por e dinë shumë mirë edhe zoti Alibeaj, edhe zoti Bardhi, sepse e shikojmë zotin Alibeaj që drejton komisionin hetimor në mënyrë korrekte, madje është shumë preciz, të jep fjalën sa herë e kërkon, por ne, zonja kryetare, e shtymë mbledhjen për një kërkesë objektive që u paraqit, dhe me të drejtë.

I kemi filluar komisionet në orën 8:00. Nëse këtu vihet pas gjumit dhe fillohet me të njëjtën referencë, që ka shkelje, bien në kundërshtim me Kushtetutën, këta zotërinjtë, që janë në minorancë janë kundër për gjithçka, sepse ne i kemi testuar forcat më 25 prill, e kemi marrë mendimin e këtyre. Plus, kanë edhe një valvul tjetër, kur ligji shkon në Presidencë, Presidenti do ta kthejë patjetër.

Ju lutem, zonja kryetare, operoni në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, që do të thotë: lexohet neni përkatës, pyetet nëse ka apo jo vërejtje për nenin përkatës, dhe hidhet në votim!

Ju lutem, zbatoheni këtë, sepse po e ktheni Komisionin e Ligjeve në komision humori!

Pas çdo fjale të Alibeajt, thuhet rrëzohet amendamenti, rrëzohet neni.

Normalisht, ne e dimë që janë kundër për të gjitha nenet, sepse i dëgjuam në votimin në parim.

Të operojmë në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, që të ecim sa më shpejtë.

Klotilda Bushka – Faleminderit!

Zonja Spiropali duhet të largohet për shkak të një mbledhjeje tjetër.

Elisa Spiropali – Kërkoj ndjesë!

Po ia heq mundësinë zotit Alibeaj të më drejtohet si Spiropali, por kërkoj ndjesë, sepse kam një mbledhje.

Drejtoresha e Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje bashkë me juristin, janë këtu.

Klotilda Bushka – Zonja Ministre, faleminderit!

Keni të drejtë të largoheni.

Elisa Spiropali – Faleminderit ju për kontributin!

Do t'ju ndjek në protagonizmin tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Vazhdojmë me nenin 11, “Strukturat shtetërore përgjegjëse për bashkëqeverisjen janë strukturat përgjegjëse për zbatimin e detyrimit të këtij ligji”.

Kemi një propozim nga zoti Alibeaj, për ta shfuqizuar nenin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, zonja Bardeli, nuk ju dëgjova, sepse kolegët tuaj bëjnë aq shumë zhurmë, sa fjala juaj nuk vjen deri këtu. Ju kërkoj ndjesë, zonja Bardeli!

Greta Bardeli – Nuk e kam në traditë dhe as nuk e kam zakon të komentoj komentuesit, por ndihem shumë e indinjuar që një zotëri, një deputet, që u largua, përmend gjumin në këtë komision. Është hera e parë që ne, si grup opozitar, i kërkojmë këtij komisioni, me dashamirësi, me mirëkuptim, sipas rregullave dhe zakoneve që na përkasin neve, si shqiptarë, për të respektuar një të vdekur, shtyhet orari i këtij komisioni për këtë arsye...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klodi, të lutem, më lër ta përfundoj!

(Diskutime pa mikrofon)

Të lutem, unë isha prezente dhe isha shumë e vëmendshme për çfarë dëgjova!

A do të më lejoni ta përfundoj? Ju lutem, komentet bëjini më vonë.

Klotilda Bushka – Zonja Bardeli, vazhdojeni fjalën, ju lutem!

Greta Bardeli – Nëse do të keni durimin që ta përfundoj, ju lutem, të jemi më me edukatë dhe etikë kur flasim! Të përmendet këtu gjumi... Nuk e ndiej veten të përfaqësuar në këtë kategori personash.

Ju lutem, tërhiqini vëmendjen zotërisë, që të kërkojë ndjesë për atë që tha, sepse edhe ne çdo ditë jemi shumë korrektë nëpër komisione dhe shumë të vëmendshëm për çka trajtohet këtu! Kështu që, ju lutem, si kryetare, si grua, ju kërkoj që zotëria të na kërkojë ndjesë për çka tha. Më erdhi keq që nuk ishte i pranishëm, por kolegët do t'ia transmetojnë fjalën.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Zonja Bardeli, jam dakord me ju, që të gjithë kolegët e këtij komisioni duhet të jenë të kujdesshëm në gjuhën që përdorin. Nëse kërkojmë nga kolegët, nuk e kam me ju, zonja Bardeli, që të kenë një gjuhë etike dhe të mos ofendojmë njëri-tjetrin, të gjithë duhet ta kenë në konsideratë këtë dhe të gjithë duhet ta respektojnë njësoj.

Prandaj, u bëj thirrje të gjithë kolegëve të jenë të kujdesshëm në gjuhën që përdorin. Sigurisht që asnjë terminologji, e cila nuk na shkon për shtat, nuk ka përse të përdoret në këtë komision.

Tani, vazhdojmë me nenin 11, sipas propozimit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju tërhoqa vëmendjen të gjithëve. Nuk jemi në kopsht këtu, zonja Bardeli.

Neni 11. Kush është pro propozimit të zotit Alibeaj për të shfuqizuar nenin? Janë 6 vota pro. Kundër? 11 vota.

Nuk miratohet ky propozim.

Kush është pro miratimit të nenit, sipas versionit të paraqitur nga qeveria, me riformulimet e dakordësuara nismëtarë-relatore? Janë 11 vota pro. Kundër? 6 vota.

Neni 12, “Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje”. Bëhet fjalë për detyrat e agjencisë dhe kompetencat e saj. Këtu kemi disa formulime të teknikës legjislative, të dakordësuara ndërmjet nismëtarëve dhe relatores.

A ka propozime të tjera?

Po, zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet ky nen, sepse në secilën nga pikat, përveç shkronjës “ç”, ka koncepte ligjore që bien ndesh me ato kushtetuese.

Së pari, në shkronjën “a” është përdorur terminologjia: “zhvillon mekanizma dhe monitoron zbatimin e tyre për gjithëpërfshirjen e qytetarëve në politikëbërje...”. Kam një pyetje, që ka një përgjigje. Ky parlament ka miratuar një ligj për konsultimin publik, që kryen pikërisht këtë gjë, vjeljen e informacioneve, të të dhënave dhe sibiliteteve nga publiku.

Ndërkohë, me këtë ligj ju po hidhni poshtë ligjin që e keni konsideruar si një nga arritjet më të mëdha të 8-vjeçarit tuaj dhe tani po e zhbëni.

Së dyti, askush nuk e ndalon qeverinë, ministrat apo institucionet e tjera, që, në qoftë se duan të bëjnë konsultim publik, ta bëjnë me dëshirën e tyre. Ajo çfarë është e rëndësishme, ku dhe kam pyetje për zonjën, që ka ulur kokën dhe nuk e ngre gjallë në botë, është kjo: në qoftë se kjo është një e drejtë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Je aty. Edhe unë këtu jam.

...në qoftë se keni një synim të mirë, dhe dua të shoh anën pozitive, pra t'u jepni të drejtën qytetarëve që ata ta japin opinionin e tyre në bërjen e politikave, në konsultimin e tyre, përse nuk ua jepni të drejtën të shkojnë në gjykatë? Unë do të isha dakord, po e them këtu, nëse e shtojmë këtë dispozitë, pra sa herë ua refuzoni qytetarëve këtë të drejtë, që ua keni dhënë për konsultim, ata të kenë të drejtën të shkojnë në gjykatë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Përndryshe, është muhabet *chat*-i pasandaj. Inovativë! Jepu të drejtën! Të drejtat bëhen reale dhe nuk janë iluzive kur t'i i njeh të drejtën qytetarit të shkojë në gjykatë, të të sfidojë. Në të gjitha dispozitat e ligjit nuk ka një të vetme, ku të thuhet: “Nëse qytetarit i mohohet një nga të drejtat e këtij ligji, nuk i jepet e drejta të shkojë në gjykatë, t’ju sfidojë”. E dimë se çfarë sistemi gjyqësor është, por t’ia njohësh këtë drejtë. Unë po flas pikërisht për këtë çështje. Ju do të dilni nesër t’ia shisni: “Politikat qeveritare, të ministrisë, janë konsultuar me publikun, janë konsultuar me mediet, kanë shprehur edhe ato se si duhet të jenë më të mira politikat qeverisëse”. Do ta thoni këtë. Nga ana tjetër, nuk keni bërë asgjë. Ama, minimumi, njihjani të drejtën publikut për të cilin flisni t’ju sfidojë në gjykatë.

Së treti, shkronja “b”: “koordinon nëpërmjet mekanizmave të posaçëm institucionalë...”. Cilët janë këta? Nuk ka një definicion. Çfarë janë këta “mekanizmat e posaçëm institucionalë”? Fjalë në eter, mbushur me poezinë romantike të Rilindjes! Kjo është e gjitha. Një fjalim e ka kthyer në ligj.

Shkronja “c” (perlë!): “publikon dhe informon publikun...”. A nuk është e njëjta gjë?! Tani, ose publikon, ose informon publikun, se të dyja nuk kanë si të shkojnë. Klasa e katërt elementare! Që të shtosh fjalë të ndryshme me të njëjtin kuptim, është tautologji dhe nuk rrit argumentin, përveçse e demaskon atë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E pra, e kanë bërë më të gjatë!

Shkronja “d”: “kërkon dhe merr nga institucionet e administratës shtetërore çdo informacion të nevojshëm për përmbushjen e përgjegjësive të saj”. Çfarë?! Ju keni të drejtë të merrni informacion nga çdo institucion, pa kufizim?! Më falni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda, mos, se re brenda me këmbët e tua! Po shoh te zonja atje.

Pra, ju merrni të dhëna sensitive, pa kufizim, për patronazhistët?

Klotilda Bushka – Ju lutem, zoti Alibeaj!

Enkelejd Alibeaj – Të lutem, po jap arsyetimin e amendamentit!

Klotilda Bushka – Ju lutem, arsyetimi i amendamentit nuk është me pyetje retorike.

Enkelejd Alibeaj – Kështu që keni shkruar në ligj që i jepni të drejtën kësaj agjencie të marrë informacion nga çdo institucion tjetër dhe nga ata që administrojnë të dhëna sensitive dhe t’i përdorni ato për qejfin tuaj, t’i përdorë Kryeministri?! Më së paku, kjo është vepër penale e strukturuar nga një bandë kriminale.

Vazhdojmë: “shqyrton kërkesat dhe organizon në bashkëpunim me institucionin përkatës të administratës shtetërore, interpelancat e Kryeministrit, të zëvendëskryeministrit dhe të ministrave me grupet e interesit, sipas kërkesës së tyre, për çështje të interesit publik ose komunitar, me përjashtim të takimeve publike që organizohen sipas ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik”. Këtu, atij që ka shkruar ligjin, i ka rënë ndër mend, në mesin e nenit, që ka një ligj për konsultimin publik; ka menduar që ka një ligj për konsultimin publik, por meqë kemi atë, atëherë të themi këtu “me përjashtim të atij ligji” dhe po bëjmë diçka tjetër. Kjo është të bësh teatër. Kjo është ajo që na keni shkruar në këtë dispozitë.

Kjo agjencia çudibërëse “rekomandon ndryshimin e rregullave dhe të procedurave të brendshme të institucioneve ose të strukturës së tyre dhe (këtu pastaj shkon përtej imagjinatës) i propozon institucionit publik përgjegjës ndërmarrjen e nismës për ndryshimin e akteve ligjore ose nënligjore...”. I kanë dhënë vetes të drejtën të kenë iniciativë ligjore! E kuptoni apo jo? Këtë të drejtë e kanë deputetët, qeveria dhe 20 mijë zgjedhës. Na del një agjenci, e krijuar nga Kryeministri, që sfidon ministrat, deputetët e të tjerë dhe ka aftësinë për të imponuar, jo për të marrë, iniciativa ligjore. Përndryshe, e di ç’të bën? Të këput kokën, se ka kontrollin. Administrata as nuk duhet të pyesë fare se çfarë thotë ministri, as se çfarë thotë sekretari i Përgjithshëm, as se çfarë thotë Drejtoria e Burimeve Njerëzore apo e personelit, ata që, në fakt, ekzekutojnë disiplinën dhe masat mbi të, jo, duhet të ketë frikë vetëm një subjekt: agjencinë, dhe duhet t’i nënshtrohet, se përndryshe e ndëshkon. Duhet të bëjë çfarë të duan ata, të mbledhë informacion të paligjshëm, t’i përdorë ato dhe ta detyrojë për të marrë iniciativa ligjore. A e kuptoni se çfarë po bëni?! Do të qeshë e do të qajë dynjaja me këtë që po bëni! Pra, i keni dhënë

kësaj agjencie të drejta, kompetenca të tilla që, do të bëni xheloz madje edhe vetë Kryeministrin. Ai nuk e ka lexuar, se zakonisht nuk i lexon këto ligje, dhe këta ia kanë shkarë. Pra, edhe të drejtën për iniciativë ligjore e merr kjo agjenci.

Klotilda Bushka – Këtu e keni gabim, zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Mos më ndërhy, të lutem!

Klotilda Bushka – Jam relatore. Ju nuk mund të shtrembëroni thelbin e nismës. Kur të mbaroni, do t'ju them se përse po e shtrembëroni.

Enkelejd Alibeaj – Kur të marrësh fjalën, thuaj çfarë ke për të thënë. Ta mbaroj fjalën dhe pasandaj vazhdo ti.

Klotilda Bushka – Përqendrohuni te neni, jo si e mendoni ju të bëhet neni.

Enkelejd Alibeaj – Zonjë, më dëgjoni, mos e bëni rrugë këtë! Se çfarë flas unë, e gjykojnë ata që janë atje. Unë po flas duke cituar dispozitat, nuk po flas në ajër.

Klotilda Bushka – Ju po i interpretoni, nuk po i citoni.

Enkelejd Alibeaj – Tani, mbani vesh dhe mësoni pak nga interpretimi.

Klotilda Bushka – Nga ju nuk kemi mësuar gjë tjetër përveç bojkotit dhe baltës, por të paktën fokusohuni tek efektiviteti.

Enkelejd Alibeaj – Tani, do ta ndërpresim? Se edhe mund ta prishim këtë mbledhje. Deri tani ishe mirë. Më lër ta mbaroj!

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj, kujdes me gjuhën, të lutem!

Enkelejd Alibeaj – Pse çfarë do të bësh ti?

Klotilda Bushka – Mos reagoni me atë gjuhë ndaj meje, se jua ndërpres fjalën, e kaloj në votim dhe fjalimet tuaja të retorikës mund të shkoni t'i bëni ku të doni.

Enkelejd Alibeaj – Ti mund të bësh çfarë të duash, por këtu nuk zhvillohet mbledhja pasandaj, të jesh e sigurt për këtë. Ti nuk bën mbledhje këtu.

Klotilda Bushka – Sigurisht që bëj mbledhje këtu, zoti Alibeaj, dhe këtë e vendos unë, nuk e vendosni ju.

Enkelejd Alibeaj – Nuk ma heq dot fjalën, jo ti, po askush, sikur të bëheni edhe të gjithë bashkë. More vesh apo jo?

Klotilda Bushka – Në qoftë se doni të vini në shina normaliteti, ju lutem, zoti Alibeaj, mos më bëni kërcënime!

Enkelejd Alibeaj – Kur kërkoj fjalën, do të flas për aq sa më takon nga Rregullorja. Po flas për dispozitën. Ke të drejtën për të folur më pas për amendamentet e tua.

Klotilda Bushka – Vazhdoni dhe flisni siç ju takon. Fokusohuni te rendi i ditës, këtë po ju them. Mos shtrembëroni asgjë. Të lutem, me mua kujdes! Gjuhën kërcënuese përdoreni në partinë tuaj, jo me mua.

Enkelejd Alibeaj – Këto kërcënime të tua merri dhe çoji në atë vendin... Dakord? Të jesh e sigurt për këtë.

Klotilda Bushka – Unë, me detyrën që kam, si kryetare, thjesht ju kërkoj të fokusoheni te rendi i ditës...

Enkelejd Alibeaj – Nuk ke asnjë të drejtë, as ti, as ndokush tjetër. Ti po të duash mbylli edhe veshët.

Klotilda Bushka – ...jo të bëni këtu aludime e interpretime, as të na mësoni dhe të na thoni që mësoni nga ne, se asnjë nuk ju ka thënë juve që jeni gjyqtari i kësaj pune.

Kështu që, të lutem, zoti Alibeaj, kujdes me fjalët ndaj meje! Nuk më flisni dot me gjuhë shantazhi, ju lutem!

Enkelejd Alibeaj – Mos më hiq të drejtën për të folur!

Klotilda Bushka – Vazhdoni, zoti Alibeaj, përmbylleni arsyetimin e propozimit që keni bërë.

Enkelejd Alibeaj – Se çfarë do të bëj, atë e di unë. Do të flas sipas rregullave të procedurës dhe po flas për ligjin. Nuk ju vjen mbarë apo ju vjen hidhur, kjo është tjetër gjë.

Zonjë, se je propozuese, tani të zuri, sepse iku ministrja, ka shkuar në permanent, punë e saj, qeveria juaj në shkronjën “ë” thotë: “kontrollon veprimtarinë administrative që kryhet nga institucionet e administratës shtetërore për ofrimin e shërbimeve publike...”. Kush jua jep të drejtën juve të kontrolloni? Së pari, kontrolli i administratës bëhet nëpërmjet ligjit për nëpunësin civil; së dyti, administratës shtetërore, që është përgjegjësia vertikale, hierarkike, si dhe nëpërmjet institucioneve të tjera të jashtme, si: ILDKPI-ja, komisionerët për mbrojtjen e të dhënave personale e me radhë. Kush jeni ju?! Me çfarë autoriteti...? Është përgjegjësi e ministrit.

Shkojmë te shkronja “f”, ku është dhe kompetenca edhe më fantazmagorike: “ndërmjetëson...”. Si i ndërmjetësoni ju zgjidhjet e mosmarrëveshjeve? Nëse ka një mosmarrëveshje, do të thotë që qytetari kërkon një shërbim, e do në kohë dhe mundësisht me cilësi. Këtë shërbim ose e merr, ose nuk e merr. Nuk ka një rrugë të mesme. Nëse ai do të marrë lejen e legalizimit, shkon në zyrën përkatëse, ka bërë kërkesën, bën pagesën, do ta marrë në kohë, nuk ia jep pala tjetër. Do parà, do shumë parà për ta marrë shteti, administrata juaj. Çfarë ndërmjetësoni ju? termi “ndërmjetësim”, zonjë, do të thotë të veprosh në një truall pa ligj. Aty

ndërmjetëson, lësho njëri, lësho tjetri. Ligji nuk bëhet objekt ndërmjetësimi, që gjysmën ta zbatojmë e gjysmën tjetër jo.

Po çfarë do të thotë kjo? Se këtu demaskoni atë çfarë keni si synim. Juve nuk ju bëhet vonë as për administratë, as për qytetarë, as për kërkesat e tyre. Ju thjesht e vetëm doni t'u bëni qejfin disa qytetarëve, atyre të cilët patronazhistët tuaj i vendosin nën mbikëqyrje, dhe këtë e konsideroni ndërmjetësim tashmë. Të tjerët i lini jashtë. Pra, kjo është ajo çfarë keni vendosur ju në ligj. Prandaj, kjo është arsyeja pse duhet shfuqizuar e gjithë kjo dispozitë.

Shkronja “h”: “Agjencia”, sepse duke ecur, duke mësuar e duke lexuar. Çfarë thashë unë? Patronazhistët? Mund të mos e besoni. Ndoshta unë mund të jem emotiv, ndoshta mund të mos jem objektiv, i përkas opozitës e kështu me radhë. Po çfarë keni shkruar ju në lidhje me patronazhistët, te shkronja “h”? Keni shkruar: “Administron bazën e të dhënave të sistemit të qarkullimit të dokumenteve me nënshkrim elektronik dhe propozon ndryshime në varësi të nevojës për përmirësim.”

Kjo do të thotë se ua keni dhënë në dorë bazën e të dhënave. E kuptoni apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në këtë pikë,

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk do të të mbrojë njeri. Që qesh një ministër, këtë e kuptoj, sepse ka mbrojtjen e atij, por ty nuk të mbron njeri nesër-pasnesër. Këtë duhet ta dish. Edhe qeshja jote e hidhur tani, në këto momente. Nuk është gjë tjetër veçse qeshje nga sikleti. Mos u përdor si vegël, si levë.

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj, vazhdoni në lidhje me nismën, sepse në lidhje me nismën nuk ka komunikim me të ftuarit, por vetëm pyetje.

Enkelejd Alibeaj – Ja pra, çfarë është kjo, kontrolli i të gjitha të dhënave në dorën e një administrate, të një subjekti të vetëm, agjencia, që kontrollon gjithçka: të dhënat po, dokumentet po, shantazhin po, iniciativën ligjore po. Gjithçka e ka në dorë vetëm qeveria private e Edi Ramës, që rri në aneksin e Kryeministrisë.

Ky pra është, me fjalë të tjera, centralizimi në ekstrem i qeverisjes. Kjo është ajo që po i jepni ju publikut me këtë. Edhe mund të qeshësh, por shqiptarët po qajnë për shkak të papërgjegjshmërisë tuaj. Duhet t'ju vrasë ndërgjegjja juve dhe njerëzit tuaj.

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj, propozimi juaj është për të shfuqizuar nenin 12...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga gjithë këto gjëra që thatë, asnjëra nuk qëndron...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Asnjëra nuk qëndron, sepse të gjitha kompetencat e agjencisë janë në përputhje me parashikimet e këtij ligji. Flitet për të gjitha mekanizmat që parashikon ligji “Për bashkëqeverisjen”, që u vijnë në ndihmë qytetarëve, si mjete komplementare dhe si mjete që përfshijnë qytetarët në vendimmarrje të caktuara.

Ndërsa në lidhje me merakun që keni për këta serverët, po jua shpjegoj: në fakt, agjencia është një one stop shop – nëse nuk e keni kuptuar akoma – elektronik i kërkesave të qytetarëve. Pra, ka një bazë të dhënash. Sigurisht, do të jetë përgjegjëse agjencia në lidhje me monitorimin e këtyre të dhënave, në kuadër të veprimtarisë, t’i ruajë dhe të jetë përgjegjëse për moskeqpërdorimin e këtyre të dhënave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meraqet e tjera që keni, të gjitha fjalimet që bëtë deri tani janë thjesht për të hedhur poshtë, ashtu siç e interpretoni ju nenin. Por neni s’ka lidhje fare me këtë, sepse s’kemi arritur ende të zbërthimet e nenit, ndaj gjithçka që keni thënë bie poshtë. Ju doni të keni këtë qasje, do të flisni këtu gjithë ditën për çdo nen, përsëritini pa problem fare.

Zonja Çano ka kërkuar fjalën për përgjigje.

Para se të hedh nenin për votim, fjala për ju, zonja Çano.

Eridana Çano – Faleminderit, kryetare!

Këtu, në diskutimet e kolegëve të nderuar të opozitës, u hodhën disa insinuata, që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni: e deputetëve të opozitës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kolegëve të këtij komisioni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Vazhdoni, zonja Çano!

Eridana Çano – Atëherë, doja t’ju sqaroja vetëm në lidhje me një moment, kur folëm për nismat dhe pse ky ligj bie në kundërshtim me konsultimin publik, dhe nuk bie. Konsultimi publik është për akte dhe nisma të qeverisë, të cilat i kryen qeveria.

Nëse ju e keni parë apo keni pasur dëshirën të futeni ndonjëherë në platformën “Shqipëria që duam”, mund të shihni se aty ka disa rubrika, të cilat u japin mundësi qytetarëve të paraqesin projekte, ide, opinione, si në linjë me politikat e qeverisë, si në idenë tjetër kur një qytetar apo një grup interesi mund t’i jetë drejtuar qeverisë dhe dëshiron të dëgjohet. Qeveria i dëgjon të tëra, i adreson te ministrinë, në përputhje me politikat qeverisëse, kërkesa që duhen parë, që ose janë anashkaluar në një moment, ose janë për t’u dëgjuar.

Faktikisht, rubrikat e platformës, përveç ankesave, se s’po merremi me ankesat, por me kërkesat, kanë të bëjnë pikërisht me këtë gjë. Kanë të bëjnë me ide për shkollën, kanë të bëjnë me ide për infrastrukturën, kanë të bëjnë me ide për të përmirësuar një segment të caktuar të qeverisjes.

Kësisoj, nuk do të doja që ju ta ngatëroni këtë ligj dhe platformën, me pjesën e konsultimit publik. Mënyra se si qytetari mund të paraqesë një nismë, një projekt-propozim apo një projekt, nuk ka lidhje fare me konsultimin publik, i cili, siç e thashë edhe një herë, por që po e theksoj, ka të bëjë me rastin kur qeveria merr iniciativën për të bërë një projektligj, një strategji apo një akt.

Shumë faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Jo, nuk mundesh. Do ta hedh në votë tani.

Neni 12, sipas sugjerimit të zotit Alibeaj, për të hequr nenin.

Kush është dakord për nenin 12, në lidhje me heqjen e tij?

Shtatë vota pro. Kundër? Nëntë kundër.

Nuk pranohet ky propozim.

Kush është dakord për nenin 12, me sugjerimet e relatores, të konsultuara e të miratuara paraprakisht me nismëtarët?

Nëntë pro. Kundër? Shtatë.

Miratohet!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, nëntë vota pro. Kundër nuk ka.

Gazment Bardhi – Nuk ka: ‘kundër’. Nuk marrim pjesë në votim.

Klotilda Bushka – Nuk morët pjesë në votim, pra.

Zoti Bardhi, ndajeni këtë çështje, sepse kur nuk ju numërohen votat dhe s’ngrini dorën, thoni: pse nuk i numëroni? Tani që nuk po i ngrini duart, tani nuk i dashkeni.

Atëherë, që nga ky moment e tutje, unë do të numëroj sa duar ngrihen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 13. Neni 13 flet për institucionet e administratës shtetërore. Titulli i nenit bëhet: “Përgjegjësitë e institucioneve të administratës shtetërore” dhe flet për përgjegjësitë që kanë institucionet e administratës shtetërore në kuptim të zbatimit të këtij ligji. Flasim për kompetencat dhe listohen të gjitha kompetencat që kanë institucionet e administratës shtetërore. E përsëris edhe një herë: bëhet fjalë për institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave, ndërsa ato të pushtetit vendor janë marrëveshje vetëm me vullnetin e tyre.

Përgjegjësitë e administratës shtetërore janë zbatimi i mekanizmave për gjithëpërfshirjen e qytetarëve, në politikëbërje dhe në garantimin e pjesëmarrjes së tyre në procedurat administrative, garantimin e përgjegjshmërisë e të llogaridhënies së çdo zyrtari, bashkëpunimin me agjencinë sipas kompetencave, rregullave e procedurave të parashikuara në këtë ligj, fillimin e procedurës disiplinore apo të procedurës së hetimit, me kërkesë të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë, dhe përfshirjen në komisione grupesh disiplinore apo hetimi administrativ, të koordinatorëve përgjegjës të agjencisë, ushtrimin e çdo detyre tjetër të parashikuar në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Punonjësit e institucioneve shtetërore janë përgjegjës për të bashkëpunuar me agjencinë në lidhje me çdo kërkesë të ardhur prej këtij ligji apo përmbushja e kompetencave të agjencisë. Mospërmbushja e detyrimeve të përcaktuara në këtë nen përbën shkak për marrjen e masave, sipas nenit 56 të këtij ligji.

Kemi rënë dakord me nismëtarët, unë si relatore, që titulli i nenit të bëhet: “Përgjegjësitë e institucioneve të administratës shtetërore”. Në pikën 1 të ndahen germa ‘ç’ dhe ‘d’. Pra, rekomandimi për fillimin e procedurave disiplinore dhe ato për fillimin e hetimeve të ndahen në dy nene. Pika ‘dh’ do të ketë një riformulim.

Në fakt, kudo në këtë ligj kemi bërë një ndryshim. Kur flitet për institucione shtetërore, zëvendësohen me fjalët institucionet e administratës shtetërore, për të mos rënë në atë për të cilën kemi diskutuar që në fillim, në parim. Duhet të jetë e qartë se cilat janë institucionet që ngarkohen me përgjegjësi dhe detyrime sipas këtij ligji, dhe e kemi thënë se janë të gjitha ato institucione në varësi të Këshillit të Ministrave, sipas ligjit 90/2012.

Këto ishin formulimet e propozuara nga nismëtarët. A ka formulime të tjera teknike në lidhje me këtë nen?

Po, zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet.

Çfarë i keni të gjitha këto? Janë llafe të tepërta, dhe llafet e tepërta janë fukarallëk. Ka vetëm një dispozitë aty, që e keni fshehur gjoja sikur ju ka shpëtuar. Është shkronja ‘ç’: “Institucionet e administratës shtetërore janë përgjegjëse për fillimin e procedurës disiplinore apo procedurës së hetimit administrativ, me kërkesën e drejtorit të përgjithshëm të agjencisë. Drejtori i përgjithshëm i agjencisë, për këdo në administratën shtetërore, urdhëron fillimin e hetimit administrativ apo procedimit disiplinor...”

Mos e tund kokën majtas-djathtas, se nuk të bën nder, sepse lexohet shqip, sepse ligji që përcakton rregullin e ruajtjes së neutralitetit të administratës, është ligj me shumicë të cilësuar për këtë arsye: për të mos e politizuar. Dhe ligji i cilësuar ka një veti; që nuk mund të

ndërfutet nga një ligj i thjeshtë, siç doni të bëni ju. Kjo nuk është gjë tjetër veçse politizim në ekstrem, duke tejkaluar një ligj me shumicë të cilësuar.

Administratën e keni politizuar, e di, me militantë të pushtetit, të Partisë Socialiste, që në 2013-ën. E ndryshuat atë ligj. Dakord. Dakord është fjalë e dhimbshme, por ka ndodhur si fakt. Deri këtu ju ka shkuar paranoja, sa edhe pse i keni militantë të Partisë Socialiste, edhe mbi ta do të ushtroni përsëri kontroll, për politizimin e tyre në mënyrë permanente.

Këtë bëni ju me këtë dispozitë, me këtë agjenci e me këtë kompetencë që i jepni. Kushdo e kupton se kjo punë është antikushtetuese. Prandaj dhe shfuqizohet e gjitha.

Klotilda Bushka – Zoti Alibeaj kërkon shfuqizimin e nenit 13.

Atëherë, si relatore, unë do të bëj vetëm një sqarim.

Së pari, administrata publike është një aset i këtij vendi, dhe të gjitha këto aludimet për politizim janë thjesht pretendime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem tani, të mbaroj unë!

Nuk bie ndesh me ligjin “Për statusin e nëpunësit civil” e drejta e agjencisë që të rekomandojë fillimin e një procedure disiplinore, nëse shkelen dispozitat e ligjit “Për bashkëqeverisjen”, pra të këtij ligji që po diskutojmë këtu. Pse? E thotë vetë ligji 132 i 2013-ës: “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore”, neni 59, pika 4: “Komisioni Disiplinor fillon procedimin me kërkesë të eprorit direkt, me rekomandim të çdo organi tjetër publik.”

Vetë agjencia është një organ që ka të drejtë në kuptim të këtij ligji, është e detyruar të kërkojë, në rastet që janë të parashikuara qartësisht në ligj, që të fillojë një procedure disiplinore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në lidhje me komisionet, meqë po më pyet Bardhi pa mikrofon, se cilat janë komisionet, komisionet janë: njëri për nëpunësit e nivelit të lartë, që është i përcaktuar në ligj, dhe një komision është për nëpunësit e nivelit të mesëm e të ulët. Nuk kemi ndonjë aludim, siç tha zoti Alibeaj, që na bie ndesh me ligjin “Për nëpunësin civil”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kemi parë me kujdes edhe me zotin Bardhi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E po ju themi: në formulimin që i kemi bërë nenit, e kemi bërë rekomandim nga ana e drejtorit të agjencisë, për të kërkuar fillimin e një mase disiplinore. Nuk është fare në kundërshtim me ligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi mendime të ndryshme, zoti Bardhi. Këtë konflikt mund ta zgjidhë në fund gjykata. Logjika është kjo: kemi një propozim nga zoti Alibeaj, për shfuqizimin e nenit 13. Më pas, kemi propozimin tim, si relatore, të dakordësuar me nismëtarët, për një riformulim të nenit 13.

Hedhim në votim propozimin e zotit Alibeaj për heqjen e nenit 13.

Kush është pro? Gjashtë.

Kundër? Dhjetë.

Nuk kalon ky propozim.

Vazhdojmë me hedhjen në votim të nenit 13, me formulimin e propozuar nga relatorja, në dakordësi me nismëtarët.

Kush është pro? Dhjetë pro.

Kundër? Në rregull, nuk morën pjesë në votim.

Miratohet neni 13!

Vazhdojmë me nenin 14. Neni 14 është: “Statusi, struktura dhe organizimi i agjencisë”.

Në nenin 14 jepen sqarime që, Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje është person juridik publik qendror, në varësi të Kryeministrit, dhe përgjigjet për bashkëqeverisjen me qytetarët nëpërmjet gjithë mekanizmave që parashikon ky ligj.

Për ta qartësuar, sepse ka pasur komente gjatë punës në grupe statusi i agjencisë. Kemi bërë disa riformulime në nenin 14. Janë riformuluar pikat 2, 3, 6, 7, ndërsa pika 8 dhe 9 janë bashkuar në një përmbajtje.

Përmbajtja e nenit 14 është në përputhje me ligjin 90/2012 “Për organizimin e Këshillit të Ministrave”.

Unë u kërkoj kolegëve, që ta votojmë, sipas propozimeve që unë, si relatore, kam dakordësuar me nismëtarët.

Ka amendament zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet, sigurisht, sepse çështja e parë që përcakton ky nen, është varësia. Në varësi të kujt është? Dhe e thotë fare qartë. Së pari, e ngre si një person juridik publik qendror, që si emër e ngre në nivel. Për çdo njeri të arsyeshëm është e pritshme që, përderisa e ngre si nivel, do të duhet që edhe masa e autonomisë të jetë proporcionale. Jo, në varësi të Kryeministrit. Këtu demaskohet e gjitha. Është në varësi të Kryeministrit.

Së dyti, kini parasysh që të gjitha kompetencat, pra të marrin informacion, të ketë iniciativë ligjore, të shantazhojë gjithë administratën, të përdoret politikisht janë në dorën e një agjencie, drejtorin e së cilës e emëron drejtpërdrejt Kryeministri dhe i përgjigjet atij.

E treta, që ju me të drejtë e keni bërë si ndryshim, agjencia ka flamurin dhe stemën e saj. Në cilën traditë legislative parashikohen flamuri, stema, vula, buxheti, pra jashtë skemës së administratës?

Për të gjitha këto arsye të shfuqizohet si dispozitë.

Klotilda Bushka – Atëherë, a jemi dakord me propozimin e zotit Alibeaj për ta shfuqizuar si dispozitë?

3 pro.

Kundër ?10 kundër.

Nuk miratohet.

Kush është dakord me propozimin e nenit 14, siç është propozuar nga relatorja në dakordësi me nismëtarët? Dakord.

Kundër këtij neni? 3 vota.

Miratohet neni 14.

Vazhdojmë me nenin 15 “Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë”.

Në variantin e depozituar nuk kemi pasur kritere për emërimin e drejtorit. Në fakt, e kemi çmuar të drejtë një koment të ngritur gjatë grupit të punës edhe nga kolegët deputetë të këtij komisioni. Për këtë arsye i vetmi ndryshim në nenin 15, i propozuar nga unë, në dakordësi me nismëtarët, është ky.

Urdhëroni, zoti Alibeaj!

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet. Përderisa në dispozitën më sipër është shkelur e gjithë skema e organizimit shtetëror, sipas Kushtetutës, ku përgjegjësia, që do të thotë: kontrolli, mbikëqyrja, politikëbërja, i takon një figure kushtetuese, siç është ministri dhe askujt tjetër, të gjitha këto dispozita për krijimin e agjencisë, që ishte dispozita më lart apo edhe në vazhdim të saj, emërimi i drejtorit të përgjithshëm nga Kryeministri, pa kaluar në procedurë parlamentare, se unë do të isha dakord të emërohej drejtori duke ndjekur të njëjtën procedurë parlamentare si për ministrat, sepse respektohet Kushtetuta, dhe çdo procedurë që nuk e respekton atë, është antikushtetuese. Për këtë arsye shfuqizohet.

Klotilda Bushka – Kush është pro propozimit të zotit Alibeaj? 3 pro. Kundër?

Nuk miratohet.

Kush është pro nenit 15, me sugjerimet e relatores? 10 pro.

Kundër? Nuk ka.

Neni 16, “Platforma “Me ty për Shqipërinë që duam”.

Në këtë nen janë bërë dy riformulime, të cilat kanë të bëjnë me korrektime e saktësime. Sqarohet qartësisht për çfarë platforme bëhet fjalë dhe ajo që ne kemi sugjeruar është shtimi i disa fjalëve dhe saktësimi i përmbajtjes së disa paragrafëve.

Urdhëroni, zoti Alibeaj!

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet, sepse në këtë dispozitë ka një parashikim, i cili bie ndesh me parashikimet kushtetuese, me mosmbledhjen e të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale sipas standardeve kushtetuese.

Me këtë nen ju nuk bëni asgjë më shumë dhe asgjë më pak se sa mblidhni në mënyrë të pakontrolluar dhe pa mekanizma sigurie të dhëna personale nga qytetarët e Republikës së Shqipërisë. Për këtë arsye kjo bie ndesh me standardin kushtetues të ruajtjes, të administrimit dhe të vjeljes me dëshirë të të dhënave personale.

Për këtë arsye duhet të shfuqizohet.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj për shfuqizimin e nenit 16?

Pro? 4 vota.

Kundër? 11 kundër.

Nuk miratohet.

Kush është dakord me nenin 16, sipas propozimit të relatores? 11 pro. Kundër? Nuk ka. Miratohet.

Neni 17 “Metodat e bashkëqeverisjes”. Këtu ka disa formulime të teknikës legislative të paraqitura nga unë si relatores në dakordësi me nismëtarët. Bëhet fjalë për të gjitha metodat dhe rubrikat e platformës së bashkëqeverisjes.

Urdhëroni, zoti Alibeaj!

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet, sepse ka një absurd logjik.

Ju thoni që bashkëqeverisja, që do të thotë muhabeti që do të bëjë kjo agjenci me shqiptarët, pra çfarë halli ke, kush nuk ta zgjidh, si ke qenë nga shtëpia e me radhë, të bëhet në bazë të një platforme “Me ty për Shqipërinë që duam”, ndërkohë një nga parimet e këtij projektligji është inovacioni, që do të thotë se mund të krijohen platforma të tjera më ta evoluara. Edhe FB-ja e ndryshoi emrin, apo jo?

Në një ligj ku ju kërkoni inovacion, platformën e konsideroni një dhe të vetme. Është fare e qartë që nëpërmjet kësaj platforme joshni, gënjeni, mashtroni qytetarët plotë halle të Shqipërisë që thjesht dhe vetëm të lënë të dhënat e tyre personale që nesër, kur të vijnë zgjedhjet, ju ta dini se cila është pika e dobët e votuesit potencial që të shkoni ta shantazhoni, ose t’ia blini votën. Kaq e thjeshtë është.

Klotilda Bushka – Është e kundërta. Neni 16 jep sigurinë e të dhënave në platformën “Me ty për Shqipërinë që duam”.

Hedhim në votim propozimin e zotit Alibeaj.

5 pro.

10 kundër.

Nuk miratohet.

Kush është dakord me nenin 17, sipas propozimit të relatores të dakordësuar me nismëtarët?

Kalon me 10 vota pro dhe 4 kundër.

Neni 18 “Hartimi i metodave dhe i seksioneve të reja, përmirësimi ose ndryshimi i tyre”.

A ka amendamente?

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet, sepse është derivat, është parazit i nenit 17. Siç e shpjegova, neni 17 është një mekanizëm për të vjelë të dhëna personale, sensitive të qytetarëve. Neni 18 nuk bën gjë tjetër veçse i kategorizon në seksione. Me të njëjtën logjikë si neni 17 duhet shfuqizuar, sepse bie ndesh me standardet kushtetuese për mosvjeljen e të dhënave personale pa pëlqimin e qytetarëve.

Klotilda Bushka – Dakord. Unë jam e bindur se të gjitha standardet për të ruajtur të drejtat e qytetarëve janë të garantuara nga ky nen dhe nga ligji në tërësi.

Hedhim në votim propozimin e zotit Alibeaj.

5 pro.

10 kundër.

Nuk miratohet.

Kush është dakord me nenin 18, sipas projektit të nismëtarëve? 11 pro.

Kundër? 6 kundër.

Miratohet.

Neni 19 “Punonjësit që kanë akses bazën e të dhënave”. Ky nen flet për punonjësit e Drejtorisë së Bashkëqeverisjes, si dhe pikat e kontaktit të institucionit shtetëror për ndjekjen e çështjeve në platformë.

Urdhëroni, zoti Alibeaj!

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet, për arsye se agjencia në dispozitat më lart kishte të drejtë të merrte informacion nga çdo institucion tjetër pa limit, pa kufizim. Informacioni që mbledh agjencia është i mbyllur dhe s’ka të drejtë ta kontrollojë askush. Pra, askush tjetër nuk kontrollon se çfarë bën agjencia me të dhënat që merr nga institucionet zyrtare apo nga publiku.

Patronaxhistët? Ky është një bunker që nuk i bindet së paku as të drejtës për informim që kanë mediet (nëse ka mbetur ndonjë gazetar këtu që ushtron këtë). Pra, me këtë dispozitë as mediet, askujt tjetër nuk i jepet mundësia ta aksesojë informacionin sipas procedurave që do të thotë se edhe kjo është një dispozitë që bie ndesh me standardet kushtetuese, ndaj të shfuqizohet.

Klotilda Bushka – Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj? 5 pro. Kundër? 10 kundër.

Nuk kalon.

Kush është dakord me nenin 19, sipas versionit të nismëtarëve? 10 pro.

Kundër? 5 kundër.

Miratohet.

Neni 20 “Administrimi, ekstraktimi dhe përdorimi i të dhënave”.

Në platformën “Me ty për Shqipërinë që duam” gjenerohet automatikisht baza e të dhënave që administrohet nga agjencia për çdo rast, të dhënat dhe historiku i rasteve të ardhura deri në zgjidhjen e tyre përfundimtare.

Nga baza e të dhënave të platformës ekstrahohen të dhëna për një çështje konkrete, të cilat përdoren për përmbushjen e qëllimit të këtij ligji, si dhe kanë cilësinë e një dokumenti zyrtar me vulë elektronike ose nënshkrim elektronik.

A ka komente për nenin 20?

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet. Asgjë nga ato që relatuar, zonja kryetare, nuk është. Neni 20 thotë: “Në platformën “Me ty për Shqipërinë që duam” gjenerohet automatikisht baza e të dhënave që administrohet nga agjencia për çdo rast. Të dhënat dhe historiku i rasteve të ardhura deri në zgjidhjen e tyre përfundimtare.”, asgjë domethënë. Se si mund të shkruhet në ligj se çfarë veprimi bën kompjuteri, tastiera “ctrl-alt”, shkruhet në ligj. Është dramë e madhe të arrish deri këtu, ndërkohë që nuk thuhet asgjë a ka të drejtë publiku të informohet, si kontrollohet informacioni që mbledh kjo agjenci, si ruhet, kush e përdor, pse e përdor, me çfarë qëllimesh, cilat veprime përbëjnë shkelje administrative, cilat përbëjnë vepër penale, se këto janë standarde ligjore që meritojnë të shkruhen në ligj, jo të shkruash se çfarë shenje do të dalë në kompjuter, në qoftë se unë shtyp në tastierë M-në, për shembull.

Vetëm për dinjitet të teknikës legjislativë do të duhet, me gjithë sytë skeptikë të zonjës që përfaqëson qeverinë, të shfuqizohet, se nuk ju bën nder, pavarësisht maskës që ke vënë.

Klotilda Bushka – Neni është shumë i qartë. S’ka asnjë nga këto shqetësime që paraqet zoti Alibeaj.

Kush është dakord për ta shfuqizuar? 5 pro.

Kundër? 10 kundër.

Nuk kalon.

Kush është dakord me nenin 20, sipas propozimit të nismëtarëve? 11 pro.

Miratohet.

Vazhdojmë me nenin 21 “Konfidencialiteti i të dhënave”. Ka disa sugjerime të dakordësuar midis meje dhe nismëtarëve.

Urdhëroni, zoti Alibeaj!

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet.

(Diskutime në sallë.)

Kolegë, jeni votuar nga qytetarët shqiptarë, paguheni nga qytetarët shqiptarë, i vidhni qytetarët shqiptarë, ju merrni edhe të dhënat personale qytetarëve shqiptar, së paku, shpjegojuani se po ua bëni me ligj tashmë!

Të shfuqizohet neni 21, sepse, jo vetëm të dhënat e mbledhura nga agjencia nuk i depërton askush veç atyre, por i shtoni edhe një mburojë tjetër. Në platformën “Me ty për Shqipërinë që duam” të dhënat e qytetarëve apo të subjekteve që regjistrohen, pra të shqiptarëve që janë nevojtarë, që kanë hall dhe thonë “jam familjar, kam kaq fëmijë, banoj këtu, s’kam shtëpi, kam këto halle” i regjistron kompjuteri. Regjistrohen në platformë dhe mbahen konfidenciale, pra askush të mos i prekë, vetëm agjencia që mbrohet nga Kryeministri. Duhet shfuqizuar, se bie ndesh me Kushtetutën.

Klotilda Bushka – Në fakt, pika 8 e nenit thotë: “Shkelja e detyrimit për konfidencialitet, sipas këtij neni, përbën shkelje të rëndë disiplinore edhe në rastet kur nuk passjell përgjegjësi penale, sipas legjislacionit në fuqi”.

Hedhim në votim propozimin e zotit Alibeaj. Pro? 5 pro. Kundër? 10 kundër.

Nuk kalon.

Kush është dakord me nenin 21, sipas propozimit të nismëtarëve në dakodësi me relatoren? Pro? 10 pro.

Kundër? 5 kundër.

Miratohet.

Neni 22 “Ndërveprimi me platformën”

Në dakodësi me nismëtarët ka disa rregullime të teknikës legjislative, siç janë në tabelë.

Urdhëroni, zoti Alibeaj!

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet, sepse përcakton mënyrën se si do të duhet të ndërveprojnë njerëzit me këtë platformë. Çfarë u thuhet shqiptarëve në këtë rast? Të gjitha ato

hallet që keni dhe u tregoni mëngjes për mëngjes te Bashkimi, te Faks-i apo TV-të e tjera, ku shqiptarët tregojnë hallet e tyre, u thuhet: “Jo më tek ato, sillini te ne!”. Aty mund të pyeten edhe për kanë votuar, ç’mendojnë për qeverisjen, cili institucion nuk po e zgjidh këtë hall dhe të gjitha të dhënat do të hidhen aty, siç ndodh edhe me *e-Albania*, që u morën të dhënat nga AKSHI-i i këtyre. I keni shkruar në ligj që të gjitha këto të dhëna të mblidhen në mënyrë elektronike. Të gjitha kërkesat e bëra me shkresa dhe me letra, as i marrin përsipër; e kanë lënë si mundësi, sipas Kodit të Procedurës Administrative. Domethënë, me të gjitha garancitë e veta, ky kod zbatohet për të gjithë ata të ngratë që marrin guximin dhe kanë kohë të shkruajnë letër, si qëmoti, ndërsa për këta të tjerët nuk ka rëndësi Kodi i Procedurës Administrative dhe të gjitha garancitë e veta.

Prandaj duhet të shfuqizohet edhe kjo dispozitë, sepse është instrumenti, me të cilin peshkohen të dhënat sensitive të shqiptarëve.

Klotilda Bushka – Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj?

Pro? 5 pro.

Kundër? 10 kundër.

Nuk kalon.

Kush është dakord me nenin 22, sipas sugjerimeve të relatores? 10. Kundër? 2 kundër.
Miratohet.

Neni 23 “Publikimi i të dhënave të platformës”.

Urdhëroni, zoti Alibeaj!

Enkelejd Alibeaj – Amendament

Jam dakord me dispozitën, por duhet të shtojmë diçka. Dispozita thotë “publikimi i të dhënave të platformës”. Duhet nxjerrë në publik të dhënat, por jo duke thënë vetëm “Metodat e platformës gjenerojnë të dhëna, raportet e të cilave publikohen periodikisht në faqen e platformës”. Cilat të dhëna? Keni detyrimin ligjor për të bërë transparencë, çka do të thotë se publikon të gjitha të dhënat e mbledhura. A ua keni marrë qytetarëve? A i keni joshur qytetarët? A i keni gënjyer qytetarët se tashmë halli i tyre është larg zgjidhjes vetëm një klik? Atëherë, bëjeni publike!

Qytetari do që, jo vetëm të thotë hallin e vet, por do të dijë sa klikime duhen për ta zgjidhur atë. Kjo do të thotë që duhet ta bëni dhe ta plotësoni dispozitën edhe me këtë shtesë. Metodat e platformës gjenerojnë të gjitha të dhënat ashtu siç grumbullohen.

Bëjeni këtë dhe keni edhe votën time për këtë dispozitë!

Ky është amendamenti që kam.

Klotilda Bushka – Hedhim në fillim në votim amendamentin e zoti Alibeaj, si më i vonshmi në kohë.

Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj? Pro? 4 pro. Kundër? 11 kundër.

Hedhim në votim nenin 23 “Publikimi i të dhënave të platformës”, sipas variantit të depozituar nga nismëtarët me sugjerimet e relatores. Kush është dakord? 11 pro. Kundër? 3 kundër.

Miratohet neni 23, sipas sugjerimit të relatores.

Neni 24 “Ankesa ime”. Është riformuluar për efekt të qartësisë së normës dhe për të qenë më i qartë gjatë zbatimit të tij. Është riformuluar i gjithi. Keni parasysh se duhet t’i referohemi për diskutim riformulimit të nenit të bërë në kolonën e tretë.

Zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Unë i referohem versionit që ka sjellë qeveria, sepse ky është versioni zyrtar. Ju kujtoj edhe një herë rregullat e procedurës që, nëse ju keni bërë amendamente në rolin e relatorit apo të deputetit, ato duhet që t’ia nënshtroni diskutimit të veçantë. Të shfuqizohet, sepse është një tallje me teknikën legjislative që çdo rubrikë, kategori që përmban faqja: “Biznesi im”, “Ankesa ime”, “Denonco korrupsionin”, “Nisma ime”, “Fjala ime”. Nuk kanë sens fare t’i përshkruash. Nuk po them atë që duhet të them, që e meriton në këtë rast. Është thjesht dhe vetëm një strategji që po bëjnë ligj, ndërkohë që, në fakt, këtu është duke u fshehur ajo se çfarë është e vërteta: mbledh të dhënat e njerëzve, centralizo pushtetin, pushtetin përdore si kamxhik, përdore si kamxhik për më të dobët, për t’i detyruar ata për t’u orientuar votën, preferencën politike. Gjithçka tjetër pastaj është propogandizëm bolshevik.

Klotilda Bushka – Propozimi i zotit Alibeaj është që të shfuqizohet neni tërësisht. Ndërkohë, propozimi im është që të miratohet neni i riformuluar sipas variantit të dakordësuar me nismëtarët dhe nuk ka asnjë ndryshim në thelb, është thjesht për qartësim të teknikës legjislative.

Hedhim në votim në fillim propozimin e zotit Alibeaj. Kush është dakord për shfuqizimin e nenit? Pro? 5. Kundër?

Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

Vazhdojmë me miratimin e nenit 24 “Ankesa ime”, sipas sugjerimit të relatores, të dakordësuar me nismëtarët. Kush është dakord? Pro 11. Kundër? Nuk morën pjesë në votim.

Miratohet neni 24, sipas versionit të propozuar nga relatorja.

Neni 25 “Biznesi im” Edhe tek ky nen ka një riformulim të përmbajtjes, pa ndryshuar thelbin, por për ta bërë më të qartë për sa i përket zbatimit në praktikë.

Zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet, sepse nuk u bindet rregullave të logjikës dhe të teknikës legjislativë. Neni 24 është “Ankesa ime”, neni 25 është “Biznesi im”. Ndryshoni nga një fjalë, pjesa tjetër mbetet vetëm “im”, pa fund. Prandaj nuk ka asnjë lloj leverdie legjislativë.

Klotilda Bushka – Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj për shfuqizimin e nenit 25 “Biznesi im”? Pro 5. Kundër? 12.

Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

Kalojmë në votimin e nenit 25, sipas propozimit të relatores në dakordësi me nismëtarët. Kush është dakord? 12 pro. Kundër? Nuk morën pjesë në votim.

Miratohet neni 25 sipas sugjerimit të relatores.

Neni 26 “Denonco korrupsionin”. Edhe këtu kemi një riformulim jo vetëm për saktësi dhe qartësi në kuadër të teknikës legjislativë, por edhe në kuadër të përafrimit dhe të harmonizimit të këtij parashikimi në ligj me veprimtarinë antikorrupsion që ka sot vetë administrata publike.

Zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet për të gjitha arsyet e mësipërme. Ju u thoni qytetarëve: “Denonco korrupsionin!”. Kaq. I kënaqni me lugë bosh. Nuk do të denoncojnë më te Bashkimi, te emisioni i mëngjesit; në fakt, do të denoncojnë edhe të Bashkimi, do të shkruajnë edhe këtu, pastaj do të presin që të mbijë bari. Kjo është e gjithë historia. Nuk shkruhen në ligj këto, se është turp i madh legjislativ.

Klotilda Bushka – Dakord.

Neni 26 “Denonco korrupsionin”, për të gjitha metodat që përdor Agjencia e Bashkëqeverisjes në lidhje me çdo rast apo indicie për korrupsionin dhe parashikimet përkatëse.

Zoti Alibeaj thotë të shfuqizohet si nen. Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj? Pro 5. Kundër 12. Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

Kush është dakord me nenin 26, sipas formulimit të relatores në dakordësi me nismëtarët. Pro 12. Kundër? 1 kundër.

Miratohet neni 26, sipas propozimit të relatores, në dakordësi me nismëtarët.

Neni 27 “Nisma ime” ka të bëjë me rubrikën në platformën “Për Shqipërinë që duam”, pra propozimet që kanë qytetarët në lidhje me programin qeverisës, nisma për akte normative apo projekte të veçanta që lidhen me administratën shtetërore.

Zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet jo vetëm për shkak të deficiencave të theksuara të teknikës legjislativë dhe mungesave të mëdha në aftësinë e fjalëformimit të leksikut dhe të

morfologjisë, por ka edhe probleme të mëdha lidhur me atë që është përmbajtja. U thoni qytetarëve: “Keni të drejtën të bëni nisma”. Të shkretët! Pastaj u thoni: “Do ta vlerësojmë ne se cilat nga nismat janë ato që vlejnë”. Tallje! Me “T” të madhe e shkruar në ligj. Kursejuani qytetarëve këtë gjë. Të shfuqizohet.

Klotilda Bushka – Kemi një propozim të zotit Alibeaj për shfuqizimin e këtij neni dhe një propozim të relatores, në dakordësi me nismëtarët, për miratimin e nenit 27 me riformulimin përkatës. Këtu jepet vetëm koncepti i “Nismës sime” dhe nuk zhvillohet koncepti se si realizohet.

Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj për ta hequr këtë nen? Pro 6. Kundër? 12.

Bie ky propozim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po edhe ndonjë gabim mund të bëj, jeni 5, thashë 6, kërkoj ndjesë. Njerëz jemi.

Ju falënderoj për seriozitetin, por ma falni edhe ndonjë gabim!

Neni 27 “Nisma ime” hidhet në votim sipas propozimit të relatores, në dakordësi me nismëtarët. Kush është pro? 12. Kundër? 2 kundër.

Miratohet neni 27 sipas propozimit të relatores.

Neni 28 “Fjala ime”. Kjo është e lidhur me një tjetër mekanizëm të platformës, që u vihet në dispozicion qytetarëve, për të komunikuar opinionet e tyre në lidhje me përmirësimin e qeverisjes. Është thjesht një platformë ndërveprimi nëpërmjet këtij programi. Kam sugjeruar në dakordësi me nismëtarët disa riformulime. Ka komente?

Po, zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet. I kanë kushtuar një nen të tërë. Fjala ime është fjalë e madhe. Shikoni çfarë shkruajnë: “Nëpërmjet platformës në seksionin “Fjala ime” qytetarët paraqesin opinionet për një qeverisje më të mirë sipas parashikimit të nenit 17”. Kushdo mund të japë një opinion në këtë platformë dhe merret agjencia 20 ditë të tëra për ta analizuar: “si e tha, me cilin e tha, është i PS-së apo i PD-së, a është mundësi që unë ta rekrutoj si votë këtij apo jo, është maxhorancë apo opozitë”. Të gjitha këto i shkruajnë në ligj, me paturpësinë më të madhe. Të shfuqizohet për këtë arsye.

Klotilda Bushka – Dakord, nuk i paragjykoj ato që toni. Ju keni mendimin tuaj, ne kemi tonin. Ne duam të fuqizojmë qytetarët, ju e mendoni sikur ne do ta keqpërdorim këtë gjë. Ndoshta, siç mendon vetë njeriu, i mendon edhe të tjerët, por nuk është ashtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Eksperiencia ka treguar që ne në 4 vjet me Agjencinë për Dialog dhe Bashkëqeverisje me qytetarët kemi ndërvepruar, u kemi zgjidhur hallet, kemi një sërë rezultatesh pozitive dhe është një gjë e provuar.

Pavarësisht kësaj, unë do ta hedh në votim propozimin e zotit Alibeaj për të hequr nenin 28 “Fjala ime”. Kush është dakord? Pro 5. Kundër? 12.

Bie ky propozim i zotit Alibeaj.

Miratojmë nenin 28 sipas propozimit të realatores, të dakordësuar me nismëtarët. Kush është dakord? 12. Kundër?

Miratohet.

Neni 29 “Interpelanca ime”. Ka disa përmirësime të teknikës legislative. Ka komente për amendamente?

Po, zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – “Interpelanca ime”. Kjo qenka tërmet fare. Domethënë, nëpërmjet platformës në seksionin “Interpelanca ime” qytetarët paraqesin kërkesat e tyre për takim publik me funksionarët e lartë politikë. Pra, për të takuar ministrin, për të takuar drejtorin, specialistin, që si rregull duhet ta takosh drejtpërdrejt, madje duhet të vijnë ata tek ti, se ti presupozohesh je sovrani, të shërbejnë ty. Jo! Ti duhet të kërkosh *online* “Interpelanca ime” dhe, pasi t’i mbushet mendja agjencisë dhe pasi të shikojnë këta, kanë kohë për të ikur në permanent apo jo, vetëm atëherë mund të japin një mundësi teorike për interpelancë; që do të thotë se kjo është ta ndash përfundimisht qytetarin e ngratë dhe ta shkelësh me këmbë *online*. Prandaj të shfuqizohet ky nen, se është turp i madh në demokracinë e vitit 2021.

Klotilda Bushka – Meqenëse zotit Alibeaj i duket se nuk është normale që qytetarët të kenë të drejtë të kërkojnë interpelanca, të takohen me ministrat, me Kryeministrin për problemet që kanë, do ta hedhim në votim propozimin e zotit Alibeaj për ta hequr nenin 29 që qytetarët të mos takohen me ministrat për hallet që kanë. Jeni dakord me propozimin e zotit Alibeaj? Pro 5. Kundër? 12 kundër.

Nuk kalon propozimi i zotit Alibeaj.

Kush është dakord me nenin 29, sipas sugjerimeve të relatores? Pro 12. Kundër? 4 kundër.

Miratohet neni 29.

Neni 30 “Shkolla ime”. Ky nen ka të bëjë me ndërveprimin nëpërmjet platformës së ankesave apo kërkesave që mund të ketë një komunitet në lidhje me shkollën, nxënës, prindër, mësues. Ka amendamente në lidhje me nenin 30?

Zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – “Shkolla ime”... Kush ka fëmijë në shkollë, e di fare mirë, e kupton që në atë traditë, që ka edhe shoqëria shqiptare, janë ato që quhen “takim me prindër”, shkohet një herë në jave, një herë në 10 ditë për t’u takuar prindi dhe për të kuptuar se ku është fëmija i tij, ku është shërbimi shkollor? Edhe këtë e hiqni dhe keni vendosur që komuniteti i prindërve përsëri *online*, si me takimet me ministrat; duhet ta prenotojë hallin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vetëm atëherë kur t’u ngrihet mendja ministrave t’u japim mundësi prindërve të shpalosin shqetësimet e tyre për gjënë më të shtrenjtë, edukimin e fëmijëve. Juve edhe për këtë traditë, që është krijuar dhe është e kalcifikuar, përsëri doni të fusni aplikimin, marrjen e të dhënave personale, kush e ka bërë aplikimin, çfarë mendojnë ata për qeverinë, çfarë mendojnë për PS-së, a mund të jenë këta votuesit tanë? Nëse nuk janë votuesit tanë, si t’ia bëjmë që të jenë votuesit tanë? Të gjitha këto janë arsye pse do të duhet të shfuqizohet kjo dispozitë.

Klotilda Bushka – Atëherë, për nenin 30, që ka të bëjë me “Shkolla ime”, ku një grup nxënësish mund të ngrenë një kërkesë për të përmirësuar institucionin në atë komunitet, zoti Alibeaj propozon shfuqizimin. Kush është dakord? Pro 5. Kundër? 12 kundër.

Nuk kalon propozimi i zotit Alibeaj.

Kush është dakord me nenin 30, sipas propozimit të relatores? 12 pro. Kundër?

Miratohet neni 30.

Neni 31 “Nota ime”. Këtu ka nga ana ime si relatores vetëm një propozim për teknikë legjislativë. A ka amendamente për nenin 31? Po, zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj - Të shfuqizohet. Te neni 31 “Nota ime” është kështu: qytetarët çdo muaj duhet të vendosin notë, një notë mesatare dhe në fund pastaj përcaktohet se sa ka qenë nota çdo muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Si ka qenë ajo në fëmijëri: “Hajde luajmë shkollash!”. Ja, kështu e bëjnë këta me qeverisjen. Për këtë arsye, për turpin e madh që po krijoni dhe po e ngrini në ligj, të shfuqizohet! Të mos dalë jashtë kësaj salle, se do të qeshë dynjaja.

Klotilda Bushka – Po qeshni vetëm ju, zoti Alibeaj, që po kënaqeni tani me teatrin tuaj. Në fakt, komuniteti i prindërve dhe komuniteti i subjekteve që marrin shërbime nga Agjencia për Bashkëqeverisjen janë më se të kënaqur, bëjnë vlerësimin, japin edhe notën e tyre për shërbimet publike. Këto janë ato vlerësime që merren nëpërmjet platformës. Para se ta hedh në votim propozimin e zotit Alibeaj, zonja Çano ka kërkuar fjalën.

Eridana Çano – Shumë faleminderit, zonja kryetare!

Doja të sqaroja 2 momente, meqenëse u kaluan nenet, që janë shumë të rëndësishme. U fol këtu nga përfaqësuesit e opozitës, nga të nderuarit deputetë për takimet me prindër që ne po i heqim me pjesën “ Shkolla ime”. Ky nen dhe ky seksion nuk ka të bëjë fare me takimet me prindër. Takimet me prindër vazhdojnë në normalitet me shkollat, me nxënësit dhe me prindërit. Kjo ka të bëjë me propozim të një projekti konkret, që ka një grup prej 5 nxënësish, 5 mësuesish dhe 5 prindërish i drejtojnë ministrisë. Kaq është minimalja. Mund të jenë 30-40, mund të jenë sa të duan, nuk e keni lexuar, besoj, mirë nenin, të cilët i drejtohen Ministrisë së Arsimit për të përmirësuar jetën në shkollën e tyre.

Shumë faleminderit!

Klotilda Bushka - Qartë!

Zonja, Çano, në rregull.

Hedhim në votim propozimin e zotit Alibeaj për nenin 31 që të shfuqizohet. Kush është dakord? Pro 5. Kundër? 12 kundër.

Nuk kalon propozimi i zotit Alibeaj.

Kush është dakord me nenin 31, sipas propozimit të relatores, të dakordësuar me nismëtarët? Pro 12. Kundër? 1 kundër.

Miratohet neni 31.

Neni 32 “Dua të kontribuoj” që është një tjetër rubrikë. Ky nen ka një saktësim të teknikës legjislativë. A ka ndonjë amendament?

Po, zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet, sigurisht! Ju po shtoni një nen, nenin 32 me dy paragrafë dhe thoni “Dua të kontribuoj”; dakord. Fillon dhe mendon njeriu, çfarë do të kontribuojë ky? Qytetarët paraqesin gatishmërinë e tyre për të kontribuar? Çfarë? Në një platformë qeveritare që menaxhohet nga qeveria, ju testoni se cilët janë ata njerëz të gatshëm për të kontribuar ose për t’u angazhuar. Kaq, asgjë, që do të thotë se nuk është gjë tjetër veçse testoni shijet politike të atyre njerëzve. Kushdo që është i gatshëm për të kontribuar ose për t’u angazhuar do të ketë vetëm një mundësi për t’u angazhuar në zgjedhje si patronazhist. Kaq e thjeshtë është. Prandaj të shfuqizohet.

Klotilda Bushka – Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj për të shfuqizuar nenin 32? Pro 4. Kundër 12 kundër.

Nuk pranohet ky propozim.

Kush është dakord me nenin 32, sipas propozimit të relatores? Pro 12. Kundër? 2 kundër.

Miratohet neni 32, sipas propozimit të relatores.

Neni 33 “Kuvendimi ynë”. Këtu kemi disa propozime për teknikë legislative. A ka ndonjë riformulim?

Zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Para se të bëjmë riformulim, t’ua bëjmë të ditur qytetarëve se për çfarë bëhet fjalë. Nëpërmjet platformës në seksionin “Kuvendimi ynë” qytetarët në kohë reale paraqesin opinione mbi tema të caktuara të publikuara në mënyrë periodike nga agjencia për një qeverisje më të mirë, sipas parashikimeve të nenit 17 të këtij ligji, të cilat analizohen nga qeverisja. Pra, i fton qytetarët për llafe, muhabet. Kaq asgjë më shumë se kaq, apo jo, Ermonela? Për të qeshur është kjo punë. E bëjmë ligj, hedhim një gjë aty dhe hajde tani kuvendojmë. Turp i madh!

Shfuqizojeni, sepse nuk ka më rëndësi, do të mbetet në analet e historisë së këtij Kuvendi një projektligj i tillë që nga 1920; bëjmë një projektligj për të bërë muhabet me njëri-tjetrin.

Klotilda Bushka – Meqenëse ju bën për të qeshur kaq shumë kuvendimi me qytetarët, po hedh në votim propozimin tuaj për ta hequr nenin 33. Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj për ta hequr nenin 33? 4 pro. Kundër? 12 kundër.

Nuk kalon propozimi juaj, zoti Alibeaj.

Kush është dakord me nenin 33, sipas propozimit të relatores? 12 pro. Kundër? 1 kundër.

Miratohet neni 33, ku vendimi ynë miratohet sipas propozimit të relatores.

Neni 34 “Kontrolli i veprimtarisë administrative”. Jepen parimet e kontrollit të veprimtarisë administrative, mënyra e kontrollit dhe cilat janë rastet. Unë kam bërë disa sugjerime për teknikë legislative. Ndërkohë, u sugjeroj kolegëve ta miratojnë këtë nen sipas sugjerimeve të mia, të dakordësuara me nismëtarët. A ka amendamente?

Enkelejd Alibeaj - Kjo nuk është për të qeshur, është shumë serioze, sepse shkon në linjë, pikërisht, me atë që thashë, me dispozitat më lart. Ju me të drejtë në pikën 1 thoni, sepse e keni parë frikën që jeni duke i tejkalluar caqet dhe kufijtë kushtetues, “Veprimtaria administrative e institucioneve të administratës shtetërore, përveç kontrollit administrativ, i cili kryhet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, mbi mjetet ligjore administrative dhe të legjisllacionit në fuqi, si dhe të kontrollit të gjykatës, (po, është e vërtetë) i nënshtrohet edhe kontrollit fshatar, punëtor”, ç’është ky i klasës punëtoare.

Unë kam një amendament: të hiqet togfjalëshi pas presjes “ i nënshtrohet edhe kontrollit nga Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje”, pjesa tjetër të ngelet, sepse është në linjë me Kushtetutën. Duke shtuar këtë, shkëlmi Kushtetutën, shkëlmi rregullin që ligjet me shumicë të

cilësuar nuk mund të tejkalohen me ligje të thjeshta, si dhe rregullin tjetër, që nuk mund të politizohet administrata publike.

Faleminderit!

Klotilda Bushka - E kam sqaruar që kur ishim te neni i parimeve përkatëse, që bëhet fjalë për një kontroll suplementar, komplementar, si një mjet plus në dyert qytetarëve, pa i rënë ndesh kontrollit administrativ dhe atij gjyqësor.

Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj, për ta hequr togfjalëshin nga fjala “i nënshtrohet”, deri te “bashkëqeverisje” në pikën 1 të nenit 34? 5 vota pro, 11 vota kundër.

Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj për nenin 34.

Hedhim në votim nenin 34, sipas versionit të propozuar nga relatorja në dakordësi me nismëtarët? Pro? 12 pro. Kundër? 2 kundër.

Miratohet neni 34.

Neni 35 “Ankesat për kontrollin e veprimtarisë dhe elementet formale të saj”. Ky është një nen, i cili përcakton të gjitha elementet e ankesës dhe kush janë ata që mund të paraqesin një ankesë. Këtu kemi një propozim nga Komisioni i Ekonomisë dhe Financave për të shtuar në paragrafët përkatës, përveç fjalës NID, edhe fjalët NUIS, të cilët kanë të bëjnë me numrat e identifikimit të personave që janë subjekte të tatueshëm apo persona juridikë.

Fjala për zotin Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj - Gjatë kësaj kohe kam thënë që mblidhen të dhënat personale. Ankesa duhet të jetë mjaftueshëm e qartë për të përcaktuar kërkuesin dhe qëllimin e saj, veçanërisht duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme, pra të përcaktojë kush është kërkuesi, numrin unik të identifikimit, NID të ankuesit, të dhënat e kontaktit, të gjitha të dhënat e kontaktit, këtë e kanë në dorë këta, shpjegimin për aktin ose veprimin administrativ, prokurën e të tjerë. Dy pikat e para së bashku me kokën e pikës 3, janë ato të cilat provojnë qartësisht atë se çfarë kam thënë deri tani, thjesht dhe vetëm kërkojnë të dhëna personale për të kuptuar kush është njeriu që ankohet atje, matanë kompjuterit, çfarë preference politike ka, si mund t'i zgjidhet halli. Unë mund t'jua them fare thjeshtë: a doni ju të rregulloni bashkëqeverisjen? Shumë mirë, sepse është qëllim pothuajse hyjnor, por, pse nuk e bëni anonim, nëse doni të identifikoni defektet e administratës, apo të qeverisjes? Ai që flet në anonimat është i sinqertë, kështu ju shërben juve, por ju këtë nuk e doni, doni të dhënat dhe këto ia përcaktoni, madje ia jepni të drejtën, agjencisë, gjithçka nga të dhënat e saj, ndryshe, ajo nuk konsiderohet e pranueshme. Ja, pra, ku e keni demaskuar qëllimin e vërtetë dhe për këtë arsye të shfuqizohet.

Klotilda Bushka – Në rregull.

Zoti Alibeaj propozon shfuqizimin e këtij neni, ndërkohë unë dua të sqaroj se të dhënat në sistem nuk mund të jenë anonime, nuk mund të ketë aplikime anonime për vetë faktin se e gjithë teknologjia e informacionit që përdoret në sistemet elektronike parashikon që duhet patjetër të logohet me të dhëna personale, siç është e-Albania, siç është edhe në të gjithë botën, jo vetëm në Shqipëri.

Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj për ta hequr nenin? 5 pro. Kundër? 12 kundër.

Nuk miratohet.

Kush është dakord me nenin 35, sipas propozimit të relatores? 12 pro.

Miratohet neni 35, sipas propozimit të relatores.

Neni 36 “Regjistrimi i ankesës dhe njoftimi i palëve”. Për këtë nen nuk kemi ndonjë riformulim nga ana e relatores dhe e nismëtarëve.

Zoti Alibeaj, urdhëroni!

Enkelejd Alibeaj – Unë sugjeroj që ky nen të shfuqizohet, por me të njëjtën logjikë që thashë më parë, sepse, nëse neni 35 është ai që i jep të drejtë pothuajse në mënyrë diktatoriale, pra pa asnjë lloj kufizimi agjencisë të kërkojë të dhëna të natyrave të ndryshme, edhe ato sensitive, neni 36 nuk përcakton gjë tjetër, veçse i jep të drejtë t’i mbajë, t’i administrojë këto të dhëna përkundërt asnjë lloj kontrolli nga jashtë, neutral, jo qeveritar, jo politik. Kështu që, edhe për këtë arsye neni 36 duhet të shfuqizohet.

Klotilda Bushka – Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj për heqjen e nenit 36? 4 pro. Kundër? 13 kundër.

Bie propozimi i zotit Alibeaj.

Kush është dakord me nenin 36, sipas versionit të nismëtarëve. 13 pro. Kundër? 2 kundër.

Miratohet neni 36, sipas versionit të Këshillit të Ministrave.

Neni 37 “Pasaktësitë e ankesës”. Për këtë nen nuk ka komente nga relatorja.

Zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj - Ky nen duhet të shfuqizohet. Një hipoteze kaq e thjeshtë “pasaktësitë e ankesës” nuk meriton që t’i bësh dispozitë me katër paragrafë. Ndërkohë, ju sapo thatë se për të bërë një ankesë të gjitha kategoritë besoj se do të jenë në faqen *online* “Shqipëria që duam”, ankesa nuk merret nëse nuk plotësohen të gjitha. Kështu që nuk ka sens të ketë edhe pasaktësi. Të vetmet pasaktësi që ekzistojnë ose mund të ekzistojnë janë kur ti vendos numrin personal, numrin e kartës së identitet gabim. Këto janë të vetmet ku mund të ketë pasaktësi dhe ju i kërkonin madje që t’i saktësojë këto pasaktësi, sepse i doni të dhënat e qarta: numrin e kartës

së identitetit, numrin personal, qendrën e votimit ku voton e kështu me radhë. Prandaj ky nen duhet shfuqizuar, sepse në ligj po ngrihet skema e patronazhistëve.

Klotilda Bushka – Zonja Çano, urdhëroni!

Eridana Çano – Për sa i përket pasaktësisë së ankesës, dua t’ju sqaroj se pasaktësitë e ankesës nuk kanë të bëjnë me kërkesën, sikundër e tha zoti Alibeaj, por, për shembull, me rastin kur për një çështje qytetari ka kërkuar diçka në ankesën e tij dhe nuk ka atashuar informacionin që duhet të atashojë që ankesa të jetë sa më e qartë, apo kur dikush kërkon në emër të një personi tjetër dhe nuk ka atashuar prokurën për të cilën e saktëson se është ai personi i autorizuar.

Klotilda Bushka – Hedhim në votim propozimin e zotit Alibeaj për heqjen e nenit 37 nga projektligji.

Kush është dakord. 5 vota pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet.

Kush është dakord me nenin 37, sipas versionit të depozituar nga Këshilli i Ministrave? 13 pro. Kundër? 2 kundër.

Vazhdojmë me nenin 38 “Verifikimi paraprak përpara fillimit të shqyrtimit të ankesës”. Këtu kemi bërë disa riformulime jo vetëm për teknikë legislative, por edhe për saktësim të disa procedurave dhe koncepteve sipas versionit të paraqitur në kolonën e tretë të tabelës.

A ka ndonjëri ndonjë koment për riformulim?

Po, zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Sigurisht, unë sugjeroj që të shfuqizohet. Ju tradhton një gjë fare e thjeshtë, germa “b”. Domethënë, ju pranoni ankesa, qytetarët janë të detyruar të japin të dhënat e tyre personale, t’ju shprehin të gjithë dhimbjen dhe lëngatën që kanë nga fakti që qeveria dhe administrata nuk u ka dhënë asnjë lloj përgjigjeje. Në germën “b” të pikës 1 ju thoni se nuk pranohet ankesa në qoftë se është paraqitur më vonë se tre vjet nga ndodhja e fakteve. Kjo do të thotë se e keni thjesht dhe vetëm për zgjedhjet, sepse njerëzit në këtë vend kanë probleme jo tre vjet, jo pesë vjet, jo tetë vjet, por ndoshta edhe më shumë, edhe kur kemi qenë ne në qeverisje kanë halle të pazgjidhura me pronat, me legalizimet, me kadastrën, me dëmshpërblimet. Jo, nuk bëhet fjalë për këto ankesa, por vetëm për këta tre vjetët e fundit. A e dini për çfarë bëhet fjalë? Për të parë këta tre vjetët e fundit sa është masa e pakënaqësisë në popull menjëherë para zgjedhjeve të pritshme, në mënyrë që nëpërmjet sistemit të patronazhistëve, me “tërmetin” e Daminait t’ju sulemi edhe një herë. Kaq është gjitha, prandaj duhet shfuqizuar.

Klotilda Bushka – Ëndërr e keqe ju është bërë ky patronazhi. U dekriminalizua tërmeti, doli patronazhi.

Vazhdojmë me nenin 38, sepse rezultatet e agjencisë dhe të këtij projektligji do t'i vlerësojnë qytetarët, siç i kanë vlerësuar deri më sot, prandaj le të vazhdojmë punën tonë.

Zoti Alibeaj sugjeron që ky nen të shfuqizohet. Kush është dakord që të shfuqizohet neni 38? 6 pro. Kundër? 13 kundër?

Nuk miratohet sugjerimi i zotit Alibeaj.

Kalojmë në miratimin ne nenit 38, sipas sugjerimeve të relatores.

Kush është dakord? 13 vota pro. Kundër? 3 kundër.

Kalojmë te neni 39 “Mënyra e kontrollit të veprimtarisë administrative”. Ne kemi bërë një riformulim në nenin 39. Nuk është ndryshuar përmbajtja e nenit, por është bërë një riformulim për saktësi dhe për teknikë legjislative.

A keni ndonjë sugjerim?

Po, urdhëroni, zoti Alibeaj!

Enkelejd Alibeaj – Unë sugjeroj që ky nen të shfuqizohet, sepse këtu shihni sa serioze është një agjenci, e cila do të kontrollojë veprimtarinë. Po marrim rastin pozitiv, nisem nga synime të mira: duan të kontrollojnë veprimtarinë e administratës me qëllim për ta përmirësuar. Kjo për çdo mendje mesatare është e pritshme që pikërisht të mënyra e kontrollit t'i kushtonin, t'i dedikonin sa më shumë dispozita të detajuara, me afate të qarta, të prera, të përcaktuara, me kompetenca dhe me të drejtat e institucionit që kontrollohen. Jo. Vetëm dy paragrafë, pika 1 dhe pika 2, agjencia vetë bën çfarë të dojë me fjalë të tjera, sepse përcakton në mënyrë të pavarur llojin, qëllimin dhe shtrirjen e kontrollit të veprimtarisë. Pra, bën çfarë të dojë, pa ligj. Ky është kontrolli. Domethënë, atë e bën atëherë kur do, e bën si do, shantazhin këdo, merr çfarëdo të dhëne që do, e përdor si të dojë, gjobit këdo jashtë çfarëdo lloj kontrolli. Të dhënat i ka aty të mbledhura, askush nuk ia kontrollon se çfarë ka mbledhur, madje janë konfidenciale dhe e gjithë kjo është një shtet policor, shtet policor dhe një qeveri private. Prandaj ky nen duhet shfuqizuar.

Klotilda Bushka – Atëherë, zoti Alibeaj kërkon shfuqizimin e nenit 39, që, në fakt, në thelb thotë: “Kur dokumentet që duhen për verifikimin janë nëpër institucionet e administratës shtetërore, administrata t'i marrë vetë, përveç atyre dokumenteve që nuk kanë qytetarët”.

A jeni dakord që ta heqim nenin 39, sipas propozimit të zotit Alibeaj. 6 vota pro. Kundër? 13 vota kundër.

Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

Kalojmë në miratimin e nenit 39. Kush është dakord me nenin 39 , sipas sugjerimit të relatores? 13 vota pro. Kundër? 6 kundër.

Miratohet neni 39, sipas sugjerimit të relatores.

Kalojmë te neni 40 “Shqyrtimi i ankesës”. Edhe këtu kam propozuar disa riformulime për efekt të teknikës legislative.

A ka riformulime, propozime, amendamente të tjera?

Zoti Alibeaj, urdhëroni!

Enkelejd Alibeaj – Unë sugjeroj që ky nen të shfuqizohet, sepse tallja ligjore me gjithë këtë procedurë vazhdon pa asnjë lloj skuqje fytyre, pavarësisht maskave që vendosin në fytyrë nga Kryeministri apo nga njerëzit që vijnë në Kuvend.

Klotilda Bushka – Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj që të shfuqizohet ky nen “Shqyrtimi i ankesës”? 6 vota pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet ky propozim.

Atëherë, vazhdojmë me miratimin e nenit 40, sipas propozimit të relatores. Kush është pro? 13 vota pro. Kundër? 3 kundër.

Miratohet neni 40.

Neni 41 “Procedura dhe afatet e shqyrtimit të ankimit”. Edhe te ky nen ka disa riformulime të relatores në dakordësi me nismëtarët.

A ka riformulime të tjera?

Po, zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Unë sugjeroj që ky nen të shfuqizohet, sepse persistenca është vlera më e madhe e të bërit të punës me seriozitet, pa u tallur. Edhe te kjo pjesë, neni 41 “Procedurat dhe afatet e shqyrtimit të ankimit” jepni një afat 10-ditor. Po nuk e bëri për 10 ditë, kërkon edhe 10 ditë të tjera, po nuk e bëri edhe për 10 ditë të tjera, kërkon prapë 10 ditë të tjera. Domethënë, shkurt tallet një administratë e tërë, e cila madje paguhet, paguhet shumë, sepse varet direkt nga Kryeministri. Kjo administratë bën sikur trajton ankesat e tyre dhe nuk jep asnjë produkt final në fund. Kështu që, për këtë arsye duhet shfuqizuar, sepse u kursejmë qytetarëve shqiptarë një tallje më shumë nga qeveria.

Klotilda Bushka – Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj, që të shfuqizohet ky nen? 6 vota pro? Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet.

Atëherë, vazhdojmë me miratimin e nenit 41, sipas propozimit të relatores. Kush është pro? 13 vota pro. Kundër? 6 kundër.

Miratohet neni 41.

Vazhdojmë me nenin 42 “Veprimet pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit dhe kompetencat”. Edhe te ky nen kam propozuar disa formulime për teknikë legislative dhe për saktësi dhe qartësi të normës.

Besoj se zoti Alibeaj do të ketë komentet e tij.

Enkelejd Alibeaj – Kjo është dispozita që jep të drejtën dhe vazhdon në vazhdën e propozimeve të mëparshme, pra të së drejtës për të bërë kontroll jashtë rregullave që përcakton Kodi i Procedurës Administrative, apo edhe ligje të tjera sektoriale që përcaktojnë kontrollin administrativ, apo kontrollin gjyqësor. Nuk ka dhe nuk ka sesi të ketë, sepse bien ndesh qoftë me dy ligjet që përmenda më parë, qoftë edhe me Kushtetutën, mundësi një organ qartazi politik të marrë masa administrative, disiplinore ndaj administratës që pretendohet të jetë e politizuar. Ky nen duhet shfuqizuar, sepse është thika politike që ngulet në kurrizin e administratës së depolitizuar që kemi ne apo pretendojmë ta ngremë. Për këtë arsye bie ndesh jo vetëm me standardet kushtetuese, por edhe me përgjërimet që do të thoshte ministria, e cila është në mungesë, për integrimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Klotilda Bushka – Neni 42 flet për detyrat e Agjencisë, pra pasi ka përfunduar kontrolli i veprimtarisë administrative dhe masat që merren në drejtim të përgjigjeve të qytetarëve. Zoti Alibeaj thotë ta shfuqizojmë këtë nen për ato arsye që parashtrori.

Kush është dakord? 6 dakord. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet.

Neni 42 do të hidhet në votim, sipas propozimit të relatores. Kush është dakord? 13 pro. Kundër? 6 kundër.

Miratohet neni 42 sipas propozimit të relatores.

Neni 43, kreu VIII “Ndërmjetësimi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me pajtim përmes Agjencisë për Dialog dhe Bashkëqeverisje”.

Neni 43 flet për ndërmjetësimin që u jepet si e drejtë institucioneve të administratës shtetërore, kur palët e zgjedhin këtë si një formë në rastet e mosmarrëveshjeve që kanë. Unë kam bërë disa riformulime, në mënyrë që të mos i biem ndesh legjislacionit për ndërmjetësimin në tërësi, si dhe kam shtuar pikën 4, ndërsa pikat e tjera janë komplet teknikë legislative. Kjo është thjesht për ta harmonizuar këtë projektligj me legjislacionin në fuqi, të cilin e kam dakordësuar, gjithashtu, me nismëtarët. A ka ndonjë vërejtje apo riformulim, zoti Alibeaj?

Enkelejd Alibeaj – Në fakt, i gjithë ky kre nuk është gjë tjetër veçse ajo se çfarë unë kam thënë deri tani në lidhje me mekanizmin që po ngrihet në ligj për patronazhistët ligjorë tashmë. I gjithë ky kre i dedikohet një koncepti fare te thjeshtë: ndërmjetësimit, pra ndërmjetësimit midis qytetarit dhe shtetit. E thashë në fillim, por dua ta përsëris edhe tani,

midis qytetarit dhe shtetit nuk mund të ketë ndërmjetësim, por ka vetëm të drejta dhe detyrime. Qytetari ka të drejtë të kërkojë shërbim, shteti ka detyrimin që t'ia japë këtë shërbim në kohë dhe me cilësi. Kjo është karakteristika e shtetit të së drejtës. Çdo largim, çdo braktisje e këtij mentalitet, se nuk është vetëm standard ligjor, por është mentalitet, është kulturë, është edukim mbi demokracinë, është rikthim në diktaturë, sepse vetëm në atë kohë mund të negocioheshin të drejtat, pra ky kre nuk bën gjë tjetër veçse krijon hapësirën për të negociuar me të drejtat e tua. Si negociohen të drejtat?! Do të marrësh pensionin, do të të rritet ndihma ekonomike, do të marrësh legalizimet, do të marrësh një vërtetim nga kadastra, do të marrësh dëmshpërblimin nga tërmetet; mund t'i bësh këto vetëm në qoftë se voton pushtetin. Kjo është negociata! Kaq e thjeshtë. Kjo agjenci mbledh të gjitha këto të dhëna sensitive, hallet dhe problemet e njerëzve. Në fund dalin patronazhistët dhe thonë: hajdeni të negociojmë. Cila është negociatë? Cila është plaçka në shpërblim? Vota për pushtetin. I gjithë ky kre, domethënë çdo dispozitë, duhet të shfuqizohet, sepse, edhe një herë, të drejtat e përcaktuara në ligj nuk negociohen asnjëherë. Ato kontrollohen ose në rrugë administrative ose në rrugë gjyqësore. Kaq! Të tjerat më pas është të shkatërrosh sistemin 30-vjeçar. Prandaj edhe kërkesa ime është që neni 43 dhe të gjitha e nenet e tjera të të shfuqizohen me të njëjtin arsyetim.

Klotilda Bushka – Në rregull, t'i hedhim në votë për shfuqizim.

Zoti Alibeaj propozon që neni 43 të kreu i "Ndërmjetësimi" dhe të gjitha nenet që vijnë më pas, të cilat kanë lidhje me ndërmjetësimin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve apo të ankesave me administratën shtetërore dhe qytetarin, të hiqen. Në fakt, jam dakord edhe unë me ju që janë çështje mentaliteti. Këto janë risi, për sa kohë nuk bien dakord ndesh me ligjin; si mjete komplementare në duart e qytetarëve janë parë si rilidhe janë në harmoni me legjislacionin në fuqi, prandaj janë propozuar. Meqenëse ju propozoni t'i heqim, atëherë e hedhim në votim.

Kush është dakord të hiqet neni 43? 4 pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet ky propozim.

Kalojmë te miratimi i nenit 43 sipas propozimit të relatores.

Kush është dakord me neni 43? 13 pro. Kundër? 4.

Atëherë, vazhdojmë me nenin 44.

Kush është dakord për ta hequr sipas propozimit të zotit Alibeaj? 4 pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet ky propozim.

Kush është dakord me nenin 44 sipas propozimit të relatores? 13 pro. Kundër? Nuk ka.

Miratohet neni 44 sipas propozimit të relatores.

Neni 45.

Hedhim në votim propozimin e zotit Alibeaj për ta hequr.

Kush është dakord? 4 pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet.

Kush është dakord me nenin 45 sipas propozimit të nismëtarëve? 13 pro. Kundër? 4 kundër.

Miratohet neni 45 sipas versionit fillestar të paraqitur nga qeveria.

Neni 46 “Komunikimi me palët”.

Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj për ta hequr këtë nen? 4 pro. Kundër? 13 kundër.

Propozimi i zotit Alibeaj për nenin 46 nuk miratohet.

Kalojmë në miratimin e nenit 46 sipas propozimit të ardhur.

Kush është dakord me nenin 46? 13 pro. Kundër? 4 kundër.

Neni 46 sipas propozimit të sjellë nga qeveria.

Neni 47.

Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj për ta hequr nenin? 4 pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

Kalojmë në miratimin e nenit 47 sipas propozimit të nismëtarëve.

Kush është dakord me nenin 47? 13 pro. Kundër? 4 kundër.

Miratohet neni 47 sipas propozimit të nismëtarëve.

Neni 48 “Mospërdorimi i të dhënave”.

Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj për ta hequr nenin? 4 pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet.

Neni 48 “Mospërdorimi i të dhënave” do të hidhet në votim sipas propozimit të nismëtarëve, pra qeverisë.

Kush është dakord me nenin 48? 13 pro. Kundër? 4 kundër.

Miratohet neni 48 sipas versionit të qeverisë.

Neni 49. Hedhim në votim propozimin e zotit Alibeaj.

Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj për ta hequr nenin 49? 4 pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet.

Kalojmë në miratimin e nenit 49 sipas propozimit të nismëtarëve.

Kush është dakord me nenin 49? 13 pro. Kundër? 4 kundër.

Miratohet neni 49 sipas versionit fillestar të sjellë nga nismëtarët.

Neni 50 “Aktmarrëveshja.”

Hedhim në votim propozimin e zotit Alibeaj.

Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj për ta hequr nenin 50? 4 pro. Kundër?
13 kundër.

Nuk miratohet.

Kush është dakord me nenin 50 sipas versionit të paraqitur nga nismëtarët? 13 pro.
Kundër? 4 kundër.

Miratohet neni 50 sipas versionit fillestar.

Neni 51. Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj për ta hequr nenin? 4 pro.
Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

Kush është dakord me nenin 51 sipas versionit të paraqitur nga Këshilli i ministrave?
13 pro. Kundër? 4 kundër.

Miratohet neni 51 sipas versionit fillestar.

Neni 52 i projektligjit, në fakt, është po në kuadrin e ndërmjetësimit, por këtu i gjithë kapitulli ka të bëjë me ndërmjetësimin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve apo ankesave të qytetarëve me pushtetin vendor, në rast se vetë pushteti vendor bie dakord që të jetë pjesë e këtij mekanizmi, sepse duhet respektuar autonomia vendore.

Për nenin 52 kam bërë disa formulime, të cilat i keni në kolonën e tretë të dakordësuar me nismëtarët.

Zoti Alibeaj, a keni këtu komente?

Enkelejd Alibeaj – Sigurisht.

Klotilda Bushka – Urdhëroni!

Enkelejd Alibeaj – Sigurisht, për dispozitat, sepse janë lidhje organike e njëra-tjetrën. Domethënë, ju vërtet u kujdesët për të treguar se cila është pika që ju shpëton sipas opinionit tuaj, pra vetëm me marrëveshje apo vetëm me dëshirë të pushtetit lokal. Në fakt, as kjo nuk ju shpëton.

Së pari, nuk mund të krijohet asnjë lloj lidhje e drejtpërdrejtë, në saj, të asaj që ju e thatë me të drejtë, autonomisë dhe decentralizmit, midis pushtetit qendror dhe atij lokal. Raportet mes tyre, komunikimi mes tyre është i përcaktuar në Kushtetutë; çfarë janë kompetencat e veta; çfarë janë kompetenca të deleguara. Me këto dispozita të këtij ligji antikushtetues ju po krijoni një mundësi tjetër për ta vendosur pushtetin lokal nën tutelë, nuk ju shpëton as ajo çfarë ju thatë

kur është me dëshirë. Po ju ua them në pushtetin lokal, edhe kur bëhen zgjedhjet normale, disa do të jenë pro qeverisë dhe disa kundër qeverisë, por edhe atyre, që mund të jenë përfaqësues të qeverisë, nuk duhet t'u krijohej mundësia, trysnia dhe t'u vihen thonjtë në grykë që t'i nënshtrohen kontrollit prej qeverisë nëpërmjet këtij ligji, sepse ata, që do të jenë të një pale tjetër politike, nuk do ta pranojnë. Po ju them që edhe hapësira që krijohet për përfaqësuesit politikë të së njëjtës ngjyrë me maxhorancën nuk duhet të krijojnë marrëveshje negociimi për të drejtat e qytetarëve me qeverinë, sepse i vendos nën kontroll; është thyerje e standardit të autonomisë dhe të decentralizimit, prandaj duhen shfuqizuar të dyja këto dispozita.

Klotilda Bushka – Për sa kohë bëhet fjalë që këtu do të jepet vullneti nga organi vendimmarrës i njësisë së pushtetit vendor nuk shikoj se ku është cenimi i parimit të autonomisë vendore, megjithatë do ta hedh në votim propozimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po nuk e miratuan, nuk do të zbatohen këto dy nene.

Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj për ta hequr nenin 52 nga ligji? 4 pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

Kush është dakord me nenin 52, sipas versionit të paraqitur nga relatorja në dakordësi me nismëtarët?

Ju lutem kolegë, a mund të merrni pjesë në votim? 13 pro.

Kundër? 6 kundër.

Miratohet neni 52 sipas propozimit të relatores.

Neni 53.

Në fillim do të hedhim në votim propozimin e zotit Alibeaj, kushtet e marrëveshjes, për ta hequr këtë nen.

Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj për ta hequr nenin 53 nga ligji? 6 pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

Hedhim në votim nenin 53, sipas propozimit të relatores.

Kush është dakord me nenin 53? 13 pro. Kundër? 6 kundër.

Miratohet neni 53 sipas propozimit të relatores.

Kreu X “Inspektimi”. Neni 54. Edhe këtu kam bërë disa sugjerime për efekt të saktësisë, harmonizimit me legjislationin në fuqi dhe për teknikë legjislative.

Besoj se zoti Alibeaj nuk do të mungojë me riformulimet e tij edhe kësaj here.

Enkelejd Alibeaj – Thashë që persistenca është virtyti i atyre që punojnë seriozisht. I gjithë ky kre, pra kreu X, që titullohet “Inspektimi dhe kundërvajtjet administrative”, nga neni 54 që bën fjalë për inspektimin, neni 55 “Konstatimi i shkeljeve”, neni 56 “Kundërvajtjet administrative”, neni 57 “Ankimi” dhe neni 58 “Ekzekutimi i vendimit”, në fakt, është zemra diabolike e këtij projektligji. I jepni të drejtë një zyre politike që do të ngrihet pranë Kryeministrit të kontrollojë të gjithë administratën, e cila duhet të zbatojë ligjin, pa ndërhyrje politike, që kjo të jetë shpata kryeministore që pret çdo kokë, edhe tuajat, në kuptimin që administratën e keni me militantët tuaj, të presë çdo kokë, e cila guxon të zbatojë ligjin, jo të dalë kundër, tej rregullave që përcakton Kodi i Procedurës Administrative apo e drejta për t’iu drejtuar gjykatës, pra kontrolli gjyqësor. Jo, drejtësinë, tashmë, e bën partia, e cila është futur në një strofull në Kryeministri që mbledh të dhëna dhe pret koka njerëzish që nuk i binden urdhrat dhe hyqmit të Kryeministrit. Pra, pra të gjitha, nga neni 54 deri te neni 58, prandaj e lexova edhe dispozitat, duhet të shfuqizohen në tërësinë e tyre dhe nen për nen.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Alibeaj!

Propozimi i zotit Alibeaj është që neni 54 për inspektimin, që unë si relatores e kam paraqitur me riformulime, të hiqet fare, a jeni dakord? 6 kundër? 13 pro.

Hidhet në votim neni 54 me sugjerimet e relatores.

Kush është dakord? 13 pro. Kundër? 6 kundër.

Miratohet neni 54 “Inspektimi”, sipas versionit të propozuar nga relatorja. Neni 55 hidhet në votim sipas propozimit të zotit Alibeaj. Pro? 6. kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet ky propozim.

Hidhet në votim neni 55 me sugjerimet e relatores.

Kush është dakord? 13 pro. Kundër? 6 kundër.

Miratohet neni 55, sipas propozimeve të relatores.

Kush është dakord që neni 56 të hiqet, sipas propozimit të zotit Alibeaj?

6 pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

Hidhet në votim neni 56 me sugjerimet e relatores të dakordësuar me nismëtarët. Kush është dakord me nenin 56? 13 pro. Kundër? 6 kundër.

Miratohet neni 56.

Vazhdojmë me nenin 57 “Ankimi”, sipas propozimit të zotit Alibeaj.

Kush është dakord ta heqim nenin 57? 6 pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

Hedhim në votim nenin 57 me sugjerimet e relatores.

Kush është dakord? 13 pro. Kundër? 6 kundër.

Miratohet neni 57 sipas propozimeve të relatores.

Neni 58.

Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj që të hiqet ky nen?

6 pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

Hidhet në votim neni 58 sipas versionit të paraqitur nga qeveria. Kush është dakord me nenin 58? 13 pro. Kundër? 6 kundër.

Miratohet neni 58.

Ndalojmë te neni 59 “Hedhja në platformë të ankesave të ardhura përmes protokollit të institucioneve”. Këtu unë, si relatores, në bashkëpunim me nismëtarët, kemi bërë vetëm një rregullim të teknikës legjislativë, një referencë gabim në ligj. Nuk kemi ndonjë gjë tjetër; jemi dakord me versionin e sjellë nga qeveria.

Zoti Alibeaj.

Enkelejd Alibeaj – Sigurisht, të shfuqizohen të katërta këto dispozita, 59, 60, 61 dhe 62.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Klotilda Bushka – Ju lutem, ta mbarojë zoti Alibeaj fjalën.

Ju lutem, zoti Alibeaj, vazhdoni!

Enkelejd Alibeaj – Në nenin 59 i kanë dedikuar një dispozitë të tërë një çështjeje që është fare banale. Domethënë, të gjitha kërkesat, ankesat e të ngratëve shqiptarë, të depozituara dhe të ngelura në pluhurin e harresës së sirtarëve të zyrave të shtetit shqiptar, t’i marrim dhe nga me dorë t’i hedhim në formë elektronike. Është një nen i tërë për një punë banale, në kuptimin e përskrimit, sepse është punë fizike, që është edhe e pagueshme, por ta ngresh në nivel ligji. Sigurisht, nuk është kaq e thjeshtë, sepse vazhdon te neni 60, që pas një momenti të caktuar, që është “Hyrja në fuqi” e këtij ligji, pastaj thuhet në një datë tjetër, pas 1 janarit 2021, çdo ankesë do të bëhet në rrugë elektronike. E centralizuar! Kjo duhet t’ju vrasë veshin, e centralizuar në një dorë të vetme, që është përsëri agjencia. Shkojnë aty deri sa thonë edhe këtë: të gjitha zyrat për marrëdhënie me publikun në administratën shtetërore, në varësi të Këshillit të Ministrave, pushojnë së ekzistuari. Këtu i tradhton, në fakt, ky parashikim, sepse i kanë konsideruar zyrat e marrëdhënieve me publikun vetëm si pritëse të ankesave të shkruara me shkrim dore. Në fakt, zyrat e marrëdhënieve me publikun nuk janë vetëm për të pritur postën; janë për të dhënë sqarim të drejtpërdrejtë, aty për aty, konsultim me legjislacionin, orientim,

për të dhënë aty, pa pasur nevojën e një letre të shkruar me shkrim apo prenotimit të një takimi, i cili nuk dihet se kur vjen në rrugë elektronike. Domethënë, është goditja më fortë që i bëhet transparencës dhe llogaridhënies. Meqenëse këto janë termat më të dashur të shoqërisë civile apo edhe të qeverisë së fasadës, i hiqni. Gjithçka e centralizuar! Do të dalë Rama nesër dhe do të thotë: me një klik në telefonin tuaj, ankesën tënde. E bën ti ankesën, i jep të dhënat, përgjigje nuk ke për të marrë asnjëherë. Do të marrësh përgjigje vetëm kur të vijë dita e zgjedhjeve, ose para, ose shantazh, zgjidh dhe merr, për të votuar pushtetin. Kështu që kjo është arsyeja, e cila përshkon të gjitha këto dispozita, së bashku edhe me nenin 61.

Neni 62 “Aktet nënligjore”. Ky ligj i tëri duhet shfuqizuar dhe nuk duhet të ekzistojë. Faleminderit!

Klotilda Bushka – Neni 59 flet për hedhjen e ankesave në platformë. Çdo ankesë, që do të shkojë në formë verbale apo në formë shkresore, duhet të hidhet në sistem.

Neni 59 flet për këtë.

Neni 60. Të gjitha zyrat tipike të pritjes me popullin do të vijë një moment që do të mbyllën. Nuk janë vetëm orientues, sepse e gjithë bota është duke shkuar drejt dhënies së shërbimit në formë *online, one stop shop*, pra formë elektronike. Nuk ka ecejake, njerëzit nuk kanë vështirësi në aksesin e shërbimeve, prandaj kjo është mënyrë konceptimi dhe prandaj ju thashë që është çështje mentaliteti, jo çdo gjë, siç e mendojmë ne, mund ta pranoni ju, por kjo është një nga mënyrat më efektive.

Unë do ta hedh në votim propozimin e zotit Alibeaj. Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj që të hiqet neni 59? 6 pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

E hedhim në votim nenin 59 me sugjerimin e relatores. Kush është dakord me nenin 59? 13 pro. Kundër? 6 kundër.

Miratohet neni 59.

Neni 60. Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj që të hiqet ky nen? 6 pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

E hedhim në votim nenin 60 me sugjerimin e relatores.

Kush është dakord me nenin 60? 13 pro. Kundër? 6 kundër.

Miratohet neni 60.

Neni 61. Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj që të hiqet ky nen?

6 pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

E hedhim në votim nenin 61 me sugjerimin e relatores.

Kush është dakord me nenin 61? 13 pro. Kundër? 6 kundër.

Miratohet neni 61.

Neni 62. Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj që të hiqet ky nen?

6 pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

E hedhim në votim nenin 62 me sugjerimin e relatores të dakordësuar me nismëtaren.

Kush është dakord me nenin 62? 13 pro. Kundër? 6 kundër.

Miratohet neni 62, sipas versionit të propozuar nga relatorja.

Neni 63 “Hyrja në fuqi”.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Enkelejd Alibeaj – Të shfuqizohet, sepse, për sa kohë që kemi kërkuar që ky ligj të mos miratohet, nuk ka sens që ky ligj të hyjë në fuqi.

Klotilda Bushka – Atëherë, hedhim në votim propozimin e zotit Alibeaj për shfuqizimin e nenit 63.

Kush është dakord me propozimin e zotit Alibeaj që të hiqet ky nen? 6 pro. Kundër? 13 kundër.

Nuk miratohet propozimi i zotit Alibeaj.

E hedhim në votim nenin 63, sipas draftit të paraqitur nga qeveria.

Kush është dakord me nenin 63? 13 pro. Kundër? 6 kundër.

Miratohet neni 63.

Atëherë, e hedhim në votim në tërësi të gjithë projektligjin.

Kolegë, kush është dakord në tërësi me projektligjin “Për bashkëqeverisjen” 13 pro. Kundër? 6 kundër.

Atëherë, me 13 vota pro dhe me 6 vota kundër miratohet në tërësi projektligji “Për bashkëqeverisjen”.

Relatorja dhe këshilltarja të bëjnë gati raportin për seancën plenare.

Faleminderit për durimin dhe për kontributin tuaj!

Për mbledhjen e radhës do të njoftoheni.

Faleminderit, zonja Spiropali!

Elisa Spiropali – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit komisionit për diskutimet!

Klotilda Bushka – Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA